



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.12.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Fatjona Dhimitri - kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Seancë dëgjimore me shoqatat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të gazetarëve, që i janë drejtuar Kuvendit për diskutimin e projektligjeve:

- "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar" (*komisioni përgjegjës*)

- "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar" (*komision për dhënie mendimi*).

2. Diskutimi nën për nën dhe në tërësi i projektligjit "Për Buxhetin e vitit 2020" (*komision për dhënie mendimi*).

Marrin pjesë:

Fatjona Dhimitri, Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Ramazan Gjuzi, Musa Ulqini, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Mirela Kumbaro, Kostaq Papa, Klajdi Qama, Selami Jenishehri dhe Erion Piciri.

Mungojnë:

Lindita Nikolla, Enada Kapllani, Amra Barova.

Të ftuar:

Ilda Londo – përfaqësuese e Instituti Shqiptar të Medias,

Ylli Rakipi – kryetar i Lidhjes së Gazetarëve Shqiptarë,

Aleksandër Çipa - Kryetar i Unionit të Gazetarëve Shqiptarë,

Mimoza Kociu – përfaqësuese e Shoqatës së Gazetarëve Profesionistë,

Kristina Voko dhe Aleksandra Bogdani – përfaqësuese të BIRN Albania (Raporterët pa kufi),

Klaudia Muçollari, Lorena Memo, Enxhi Sula - përfaqësues të Këshillit Shqiptar të Medias,

Brixhilda Dhima – përfaqësuese e Komitetit Shqiptar të Helsinkit,

Artan Rama, Djana Malaj- përfaqësuese e Qendrës “Res Publica”,

Elvin Luku – përfaqësues të Qendra Shqiptare “MediaLook”,

Megi Reçi – përfaqësuese e “Civil Rights Defenders”,

Lorin Kadiu – përfaqësues i “Citizens Channel”.

Prezent përfaqësues të OSBE:

Irina Radu – Senior Media Officer nga OSBE,

Elira Canga - National Media Project Officer nga OSBE,

HAPET MBLEDHJA

Fatjona Dhimitri – Ju përshëndes dhe ju falënderoj për pjesëmarrjen tuaj në këtë mbledhje!

Sot në rendin e ditës do të kemi seancën dëgjimore me shoqatat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe gazetarët, të cilët i janë drejtuar Kuvendit për diskutimet e projektligjeve: “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, ku ne jemi komision përgjegjës, komision për dhënie mendimi do të jetë Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, dhe “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918. datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, ku ne jemi komision për dhënie mendimi dhe komision përgjegjës është Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Të ftuar nga Instituti Shqiptar i Medias kemi zonjën Ilda Londo.

Milva Ekonomi- Zonja kryetare, a mund ta marr fjalën për procedurë?

Fatjona Dhimitri- Po, urdhëroni!

Milva Ekonomi- Faleminderit shumë!

Mirë se keni ardhur të gjithë!

Unë dua të vë në vëmendje të të gjithëve që janë sot present, që pak kohë më parë ne kemi marrë edhe një letër nga ju, ku tregoni shqetësimet dhe kërkonit që të ishit pjesë e dëgjësave për këtë projektligj. Pasi komisioni mori letrën, bëmë një mbledhje komisioni dhe ramë dakord për kthim përgjigje, të cilën jua nisëm. Kështu që unë besoj se të gjithë e keni marrë përgjigjen që ka kthyer komisioni me një numër protokolli të ardhur nga Kuvendi.

Gjithashtu, ne kemi lexuar deklaratën tuaj të djeshme lidhur ..

Fatjona Dhimitri- Zonja Milva, unë akoma nuk kam mbaruar...

Milva Ekonomi- Unë po e kërkoj për procedurë...

Fatjona Dhimitri – Zonja Milva, keni folur dhe mjaftueshëm. Unë nuk e kuptoj. Unë i kam njoftuar shërbimet e komisionit që ditën e djeshme mbledhja të mos ishte zhvilluar pa prezencën time...

Milva Ekonomi- A mund ta përdorim kohën në mënyrë efektive?

Fatjona Dhimitri- Jo, Milva. Ta jap unë fjalën më vonë. Unë nuk e kuptoj urgjencën qeveritare, e cila ka ndezur sirenat e alarmit për të kaluar sa më parë projektligjin e censurës.

Milva Ekonomi- A mund të bëj një propozim?

Fatjona Dhimitri- Jo, fare! Sot është dita e medias dhe e gazetarëve për t'u dëgjuar për projektligjin.

Milva Ekonomi- Unë propozoj që në këtë moment të gjitha shqetësimet që keni, t'i jepni të përqendruara, duke folur njëri nga ju, pastaj gjërat e tjera le të shtohen nga të gjithë, sepse, po ta merrni fjalën të gjithë dhe të përsëritni të njëjtat gjëra, është e pamundur ta menaxhojmë kohën. Kështu që thirrja ime është që të caktoni njërin prej jush që të japë shqetësimet kryesore...

Ylli Rakipi- Jo, zonjë, nëse ke kohë të na dëgjosh, na dëgjo, nëse nuk ke, mbylle mbledhjen.

Fatjona Dhimitri- Kush është i interesuar nga pala e maxhorancës për të dëgjuar, le të dëgjojë. Të gjithë do të dëgjojnë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Vazhdoni, zoti Rakipi. Të gjithë do të dëgjojnë. Kush ka interes nga maxhoranca, le të rrijë, kush nuk ka, le të largohet.

Ylli Rakipi- Ju keni qenë një grua tjetër dhe më vjen keq që ju shoh në këtë gjendje. Shumë turp!

Milva Ekonomi - Mos ma qani hallin.

Ylli Rakipi - Ta qaj hallin, por ti s'i qan dot hallin vetes.

Fatjona Dhimitri - Me sa duket qeveria po e kalon me shpejtësi...

Ylli Rakipi - Ti nuk e lë kolegen të flasë.

Fatjona Dhimitri- Qeveria për të mbuluar keqqeverisjen e pasojave të fatkeqësisë natyrore po kërkon që ky projektligj të kalojë me shpejtësi të madhe.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Çfarë kërkon, zotëri?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Hiç fare, sepse po ta marrin të gjithë fjalën për procedurë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Arrogancën po e bën qeveria juaj, e cila e ka sjellë ligjin këtu. Dëgjoji të gjithë të ftuarit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk ju dëgjoj fare. Këtë avaz ke ti përherë.

Hapim seancën dëgjimore.

Milva Ekonomi- Nuk mund të silleni kështu me një deputet të komisionit, sepse për procedurë po e merr fjalën.

Fatjona Dhimitri – Le t’i shprehë ankesat që ka ndaj meje në Konferencën e Kryetarëve.

Ismet Beqiraj – Je e detyruar të ma japësh fjalën për procedurë.

Fatjona Dhimitri - Jo, nuk ta jap fare.

Ismet Beqiraj – Me Rregulloren e parlamentit je e detyruar të ma japësh fjalën.

Fatjona Dhimitri - Çfarë kërkon, çfarë do? Ti po vë censurë ndaj medias, si qeveria juaj.

Ismet Beqiraj - Nuk ka censurë. Vetë dëshmia e këtij realiteti këtu në këtë sallë, ku është ftuar kushdo që ka kërkuar, sipas Rregullores, është prezent...

Fatjona Dhimitri - Dhe ne do t’i dëgjojmë të gjithë. Çfarë kërkon?

Ismet Beqiraj - Të gjithë do t’i dëgjojmë. Ndaj, në radhë të parë ju, si drejtuese e seancës, duhet të respektoni Rregulloren.

Fatjona Dhimitri- Unë nuk e kam hapur ende seancën dëgjimore, ju më ndërprisni.

Ismet Beqiraj- Edhe për të ftuarit ka një rregullore. Ata mund ta marrin fjalën, por nuk jemi në studio televizive që të bëjmë debat, kur u jepet fjala.

Fatjona Dhimitri- Pse, ata duhet të thonë çfarë doni ju?!

Ismet Beqiraj – Sot nuk jeni thirrur të bëni *show* televiziv.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatjona Dhimitri -Jo, zotëri, nuk po bëjmë *show*. *Show*-n po e bëni ju.

Ismet Beqiraj- Ne kemi një Rregullore të parlamentit dhe unë këtë po kërkoj. Në qoftë se ju, edhe si media, doni të shkelet Rregullorja e Kuvendit, që këtu jepet një shembull negativ.

Fatjona Dhimitri- I zbatoni shumë bukur urdhrat e kryetarit tuaj, Ismet!

Ismet Beqiraj – Ne kemi të drejtë, me Rregullore, të ndërhyjmë sa herë të duam.

Fatjona Dhimitri- I ka rreshtuar autokrati një për një ushtarët e tij.

Ismet Beqiraj- Ju do të flisni kur t’ju jepet fjala, sepse për këtë keni ardhur sot.

Fatjona Dhimitri- Hapim seancën dëgjimore. Të ftuar nga Lidhja e Gazetarëve Shqiptarë, kryetar, zoti ylli Rakipi; nga Unioni i Gazetarëve Shqiptarë, zoti Aleksandër Cipa; nga Shoqata e Gazetarëve Profesionistë, zonja Mimoza Koçiu; nga BIRN Albania, Kristina Voko dhe Aleksandra Bogdani; nga Këshilli Shqiptar i Medias, zonja Klaudia Muçollari, zonja Lorena Memo dhe zonja Enxhi Sula; nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, zonja Brixhilda Dhima; nga Qendra “ResPublica”, zoti Artan Rama dhe zonja Djana Malaj; nga Qendra Shqiptare “MediaLook”, zoti Elvin Luku; nga “Citizen Chanel”, zoti Lorin Kadiu.

Fjalën e ka zonja Mimoza Koçiu.

Ju falënderoj për pjesëmarrjen dhe gatishmërinë e treguar për seancat dëgjimore të komisionit tonë!

Mimoza Koçiu- Mirëmëngjesi të gjithëve!

Unë jam Mimoza Koçiu, përfaqësuese e Shoqatës së Gazetarëve Profesionistë të Shqipërisë. Nuk m'u dha mundësia që të them se jam unë që do të jap deklaratën në emër të të gjithëve dhe nuk kishte pse të bëhej i gjithë ky debat. Ne prandaj ju kemi sjellë kopje të deklaratave, që nuk është vetëm një deklaratë, por është deklarata e 7 organizatave të huaja ndërkombëtare të medias, ku dje ka reaguar edhe Federata Ndërkombëtare e Gazetarëve, e cila ka 600 mijë gazetarë, në 145 vende të botës dhe Federata Europiane e Gazetarëve, që ka 320 mijë gazetarë në 22 vende të botës. Siç e shikoni, kemi një komunitet të madh të medias, që na përcjellin dhe na mbështesin, pra nuk jemi të vetëm. Ky është një shqetësim që e ndajnë kolegët tanë në vendet e tjera të botës, edhe në demokracitë shumë të zhvilluara, jo vetëm në tonën.

Ajo që ju kemi paraqitur në deklaratë, nuk dua t'ju lexoj të gjithë deklaratën, meqenëse edhe zonja Milva tha që e keni parë, është që ne, si grupim prej 15 organizatash, kemi një pjesëmarrje të madhe, që as te Komisioni i Ligjeve nuk ka qenë kaq e madhe. Ne e dimë që ju jeni komision përgjegjës dhe për pasojë shpresojmë që ju të keni ndjeshmërinë më të madhe, për të kuptuar shqetësimet që po ju sjellim.

Ne, si grupim prej 15 organizatash të gazetarëve dhe shoqërisë civile, në mënyrë të përsëritur, që prej dhjetorit të vitit 2018, sepse është një betejë që ne po e zhvillojmë prej një viti, nuk po e nisim sot, as para disa javësh, kur këto projektligje ju kanë ardhur në Kuvend, përmes deklaratave tona publike i kemi kërkuar qeverisë të tërheqë të dyja projektligjet e prezantuar publikisht si "Paketa antishpifje", duke renditur të gjitha kundërshtitë tona. Ne themi se Shqipëria ka mjaftueshëm ligje që rregullojnë çështjet, ku media shkel të drejtat e njeriut dhe çdo ndërhyrje tjetër. Në këtë drejtim ka pasur disa precedentë të gjykuar në sistemin tonë gjyqësor. Pra, ne nuk kemi konstatuar raste kur shpifja apo *fakenews*-i i medias nuk ka gjetur adresim nëpër gjykata.

Edhe te procesverbalin juaj, relacioni shoqërues i këtyre dy projektligjeve, që ishte i njëjti relacion, nuk kishte një studim me shifra, ku të bazohej shqetësimi për të pasur këtë ndërhyrje në ligjin për mediat, që ne e quajmë përpjekje për censurë. Prandaj ju kërkojmë që t'i tërhiqni të dyja.

Unë dua të përmend listën e organizatave që kanë firmosur në Shqipëri, sepse listat e organizatave të huaja i keni. Ato janë: BIRN Albania; Civil Rights Defenders; Citizens Channel; Faktoje; Instituti Shqiptar i Medias; Instituti Shqiptar i Shkencave; Këshilli Shqiptar

i Medias; Komiteti Shqiptar i Helsinkit; Lidhja e Gazetarëve të Shqipërisë; New Media Network; Qendra Res Publica; Qendra Shqiptare MediaLook; Qendra Shqiptare për Gazetari Cilësore; Shoqata e Gazetarëve Profesionistë të Shqipërisë dhe Unioni i Gazetarëve Shqiptarë.

Edhe në media, njësoj si në politikë, ne nuk jemi të gjithë në një zë, por, si kurrë më parë, këtë herë jemi të gjithë bashkë. Fakti që jemi të gjitha organizatat bashkë, duhet të jetë një sinjal për ju që ta kuptoni se ne e kemi shqetësim të përbashkët dhe nuk është shqetësim që shkon përtej këtyre dy projektligjeve apo përtej një mandati apo dy mandatesh. Jo, ky është shqetësim që e kemi përgjithmonë, sepse në Shqipëri gazetaria ka filluar që në muajin janar të vitit 1991 me gazetën “Rilindja Demokratike”, atëherë kur ka filluar pluralizmi i mendimit. Prandaj, mos e cenoni atë 30 vjet më vonë.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri- Faleminderit, zonja Koçi!

Fjala për zotin Rakipi.

Ylli Rakipi – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zotërinj deputetë, që qoftë edhe formalisht, ju thirrët gazetarët në një aventurë për të implementuar një ligj fashist, i cili vjen me iniciativë të Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, kryetarit të këtij regjimi që po instalohet në Shqipëri, zotit Edi Rama.

Mediat *online* në Shqipëri, si në të gjithë botën, janë krijuar si një mundësi për t'i shpëtuar kontrollit nga pronarët e mediave tradicionale. Kjo ndodh edhe në SHBA dhe në vendet më demokratike të botës, në Britani, në Francë dhe në të gjithë botën, për shkak të deformimeve që ka marrë demokracia liberale në këto kohë dhe për shkak të vështirësive të jashtëzakonshme që ka sistemi ynë. Ju më mirë se ne e shihni se çfarë po ndodh në politikën europiane apo atë amerikane, ku liritë kanë një përpjekje për t'u kufizuar nga njerëzit që vijnë në fuqi, me interesat e ndryshme apo me pafuqinë e grupimeve të mëdha, qoftë të Bashkimit European apo të tjera.

Siç e thashë, “Paketa antishpifje” është iniciativë personale e Kryeministrit, që e ka prezantuar disa herë publikisht. Mospëlqimi i Kryeministrit është i njohur botërisht dhe i artikuluar prej tij në dalje publike të panumërta, që ju vetë i keni parë. Ndoshta një pjesë juaja jeni kënaqur me daljet e liderit tonë, i cili, përveç përmbajtjes, asaj që thotë, demonstroi edhe forma nga më të ndryshmet dhe më të çuditshmet, deri edhe Profetin Muhamed, ku, siç e keni vënë re, ai vishet me këmisha si të atij, por kjo është punë e liderit.

Gjuha e përdorur, siç e keni vënë re, zotërinj deputetë, është fyese, denigruese, poshtëruese, duke përdorur ndaj medias fjalët “qenef”, “hale” dhe duke i thënë një qeni nëpër

rrugët e Kasharit: “Pushoje atë analist”. Pra, lideri ynë ka të drejtë të thotë çfarë të dojë, ndërsa ne duhet të pushojmë dhe të dëgjojmë liderin tonë.

Siç e thashë, projektligjet e propozuara kanë frymë fashiste dhe e vendosin median *online* nën kontrollin e dy institucioneve, që i krijon qeveria. Pra, juve ju është dërguar një projektligj që ta ktheni në ligj, për të ligjësuar urdhrin administrativ të kohës së Enver Hoxhës. Pra, do të ngrihet AKEP-i dhe AMA e do të marrin vendime për të goditur median, me ato shifra, ato problematika dhe me atë mbyllje që kërkon lideri ynë suprem. Urdhri administrativ do të dalë mbi drejtësinë, mbi gjykatat. Kjo po ju kërkohet juve, zotërinj deputetë, që ta vulosni dhe ta firmosni në datën 19. Bëjeni, por duhet të dini një gjë të thjeshtë: ky do të jetë turpi juaj!

Edhe qeveritë e kaluara kanë bërë përpjekje të shëmtuara. Edhe administrata e Sali Berishës ka bërë përpjekje të shëmtuara me ligjin, me një gjoja shartim, që gjente copëza të ligjeve perëndimore për t’i implementuar dhe për t’u mbyllur zërin gazetave, aq sa ishin atëherë, dy televizione dhe gazetave, por nuk e bëri dot dhe sot përmendet si një turp. Turp do të mbetet po e bëtë ju. Këto projektligje, të nderuar deputetë, nuk janë të ngjashme me asnjë iniciativë në vendet demokratike. Edhe sikur të shartoni copëza dhe të ndërtoni një ligj me copëza të marra aty-këtu, nuk e bëni dot, sepse do t’ju dalë shëmtirë dhe nesër do t’ju vijë turp nga vetja. Ndoshta s’ju vjen turp sot, por nesër do t’ju vijë. Këshilli i Ankesave brenda AMA-s do të ketë mundësi të vërë gjoba për gazetarët shqiptarë, që pronarët, të cilët kanë rrëmbyer çfarë kanë dashur dhe vazhdojnë të rrëmbejnë këtë copë vend, që kanë rroga të turpshme minimale dhe media *online* duhet të paguajnë 400-800 mijë lekë, duhet t’ia paguajnë Edi Ramës. Me këtë ligj ti nuk ke të drejtë të shkosh në gjykatë, por duhet t’ia paguash liderit. Ti duhet të paguash paratë, pastaj të shkelësh në gjykatë. Kjo është fashiste. Ju po bëni veting, po zgjidhni drejtësi të re dhe nuk keni besim te kjo drejtësi, por do të vendosni vetë drejtësi. Vendosja e një dritareje *pop-up* për mediat *online*, që sipas Këshilli të Ankesave ka kryer shkelje, është mendësi totalitare. Kjo praktikë nuk i shërben askujt, por është veç një përpjekje për të denigruar median me agjitacion e propagandë.

Unë jam dëshmitar i dy gjyqeve të liderit tonë në gjykatën e Tiranës. Më ka thirrur për agjitacion-propagandë dhe kërkon të më dënojnë për agjitacion-propagandë. Kjo vetëm sepse unë them atë që mendoj për liderin tonë suprem. Një turp i madh! Nuk është për shpifje, por ajo që unë mendoj. Merreni me mend se çfarë do të bëjë ai me 4 veta, që do t’i caktojë vetë në Këshillin e Ankesave! Nuk ka asnjë garanci që personat, të cilët do të shërbejnë në Këshillin e Ankesave, kanë pavarësi nga politika. Ne jemi njerëzit që i përcjellim popullit atë çfarë ndodh këtu dhe ne e shohim çfarë ka marrë dhe çfarë ka rrëmbyer lideri. I ka mbetur vetëm një kryetar shteti, që del dhe shan Dvoranin dhe del e bën koperturën e regjimit, të cilit dje në një emision

i thashë: “Ti je kryetar i regjimit, jo i shtetit”. Ky është i vetmi njeri që ka mbetur përballë tij dhe të gjitha institucionet e tjera kanë rënë. Opozita ka dalë jashtë parlamentit, që nuk e dimë se ku është sot, të nderuar deputetë, dhe çfarë vendimesh ka marrë për interesa të veta. Nëse mundeni, jini në krahun e gazetarëve.

Publikimi i përgjigjes apo komentet që citon projektligji të subjektit të prekur nga publikimi është parimi i çdo medieje profesionale. Nëse unë bëj një gabim në medien time për zotërinë deputet, gazetarin apo qytetarin e Republikës së Shqipërisë, jam i detyruar ta përgënjeshtroj dhe të shkoj deri në gjykatë. Ne kemi një ligj etike të shartuar me kodin anglez dhe gjerman. Le të mblidhen gazetarët dhe ta bëjnë me ligj atë. Le të përjashtohen gazetarët nga puna, siç kanë bërë në pjesën dërrmuese të historisë së vet vendet gjermanike, Austria dhe Gjermania, të cilat mekanizmin vetërregullues e kanë kthyer në ligj. Prandaj ne duhet t’ju kërkojmë ju që ta ktheni në ligj, në mënyrë që ne të dënojmë veten tonë. Edhe ne kemi gabime dhe ju keni plot gjëra të thoni për ne, por në momentin që ju merrni përsipër të bëni një ligj për t’i mbyllur gojën medias dhe medias *online*, është turp i madh për një vend, i cili ka problemet e veta të panumërta dhe po lëngon edhe për tragjedinë që i ndodhi dje. Si është e mundur që një vend me këtë tragjedi, ku njerëzit nuk kanë ku të futin kokën, mblidhet dhe kërkon të votojë një ligj kundër gazetarëve dhe kundër medias së lirë?!

Të nderuar deputetë, ky është një ligj i panevojshëm, kur ndërkohë ligji shqiptar ofron të gjitha mundësitë që një subjekt t’i drejtohet gjykatës, në rastin që pretendon shkelje nga ana e medias.

Siç e keni parë, Kryeministri i vendit, që ju adresova problemit tim, por që ka me dhjetëra padi drejtuar gazetarëve të tjerë, u është drejtuar gjykatave me padi për një numër të madh gazetarësh. Ja ku janë gjykatat, po rregullohen. Ju thoni që kjo është reforma më e mirë që po ndodh, atëherë çojini në gjykatë, edhe ju këtu na çoni ne në gjykatë, dhe të vendosë ajo për ne, të vendosë ligji për ne, por jo urdhri administrativ. Ky është një ligj i panevojshëm dhe insistimi për ta miratuar, pas kritikave të shumta nga shoqatat e gazetarëve dhe komuniteteve ndërkombëtare, është një tregues, më shumë se kurrë në këto 30 vjet, sidomos nga bashkësia ndërkombëtare, edhe pse kjo bashkësi në një pjesë të mirë të aktivitetit të vet, për hir të stabilitetit të Shqipërisë sonë të bukur, është bërë një me liderin tonë, është bërë një me regjimin, ndërsa në këtë rast është 100% me gazetarët.

Të nderuar deputetë, lideri i këtij regjimi po bën përpjekje për të vënë nën kontroll medien. Unë mendoj se, nëse ju do të keni vullnetin e mirë dhe do të shikoni se çfarë ndodh, atëherë ndoshta mund të korrigjoni edhe një budallallëk që po bëhet në ditët e sotme. Siç mund ta keni vënë re jo vetëm në vendin tonë, por në të gjithë botën, bëhen budallallëqe nga më të

panumërtat, duke filluar nga liderët më të mëdhenj që ka zgjedhur kjo botë, që të mos përmendim emra. Bëni një të mirë për medien, hidhini poshtë këto dy projektligje, sepse do të ishte një gjë e mirë edhe për ju.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Faleminderit, zoti Rakipi!

Fjala për zonjën Kristina Voko, nga organizata “BIRN Albania”.

Kristina Voko – Përshëndetje!

Në radhë të parë, faleminderit për ftesën dhe për fjalën!

Ne kemi qenë një ndër organizatat që u jemi bashkuar deklaratave të përbashkëta, që, siç e përmendi edhe Moza, kanë filluar në dhjetor të vitit të kaluar me dy projektligjet e para të hartuara, më pas, sigurisht, kemi pasur variante të ndryshme për këto dy projektligje. Duhet thënë që varianti fillestar është miratuar nga qeveria shqiptare, të cilin ju e keni marrë, sepse në fillim të korrikut të vitit 2019 kanë ardhur në parlament të dyja variantet, të cilat nuk kanë kaluar asnjë procedurë konsultimi, asnjë procedurë të marrjes së mendimit nga grupet e interesit. Të mos harrojmë se ai ishte një miratim dhe, në mos gaboj, ishte në mbledhjen e parë të qeverisë, menjëherë pas zgjedhjeve lokale të këtij viti. Të dyja projektligjet u tentuan të kalohen vitin e kaluar, të cilat, pavarësisht se u ndeshën me kundërshtinë shumë të gjerë të institucioneve dhe organizatave lokale ndërkombëtare, u prezantuan në periudhën e Krishtlindjes e kështu me radhë. Pra, e mbështes opinionin e parafolësve që thanë se duket një presion shumë i madh dhe ndoshta në kohë të papërshtatshme për të kaluar dy projektligje, të cilat ne i konsiderojmë si ligje për censurë. Edhe dje kjo ishte një kërkesë e vazhdueshme e Komisionit të Ligjeve, që të shkojmë në komente konstruktive, për sa u përket komenteve që ne kemi nën për nen. Megjithatë, shpresoj se me deklaratat tona të ketë qenë e qartë që ne i refuzojmë në parim këto dy projektligje, sepse këto dy projektligje janë pikërisht rishikimi i ligjit të AMA-s dhe AKEP-it, pra të dy institucioneve administrative, të cilat marrin përsipër të rregullojnë përmbajtjen e medias. Në asnjë vend tjetër demokratik nuk ka ligje të ngjashme, por e vetmja tentativë e ngjashme ka qenë në mars të këtij viti nga Rusia e Putinit, të cilat ishin iniciativa të kundërshtuara gjerësisht dhe përsëri nuk shkojnë në këto detaje që këto dy projektligje kanë ndërmarrë. Gjithashtu, di që gjatë diskutimeve të djeshme të këtij komisioni janë hedhur teza të ndryshme që këto janë iniciativa që po ndërmerren edhe në Europën Perëndimore dhe në SHBA, dhe ne jemi pararoja e tyre. Jo, nuk ka asnjë vend tjetër që ka ndërmarrë iniciativa të tilla.

Në relacionet e këtyre dy projektligjeve, që kanë qenë të ngjashme që në muajin dhjetor të vitit të kaluar, pretendohet se janë marrë si model, duke imituar apo kopjuar modelet e

ngjashme të vendeve europiane. Nuk është aspak e drejtë. Në deklaratat tona të mëparshme mund t'i gjeni të gjitha kundërshtitë lidhur me modelet e supozuara, ku janë bazuar këto dy projektligje. Pra, nuk ka asnjë vend tjetër, i cili u jep dy organeve administrative kaq kompetenca, AMA-s dhe AKEP-it, të cilat në të gjitha raportet ndërkombëtare dhe në raportet lokale janë akuzuar se janë politikisht të kontrolluara, që të marrin në dorë kontrollin e përmbajtjes dhe kufizimin e medias.

Megenëse jemi te procedurat e Kuvendit, mund të them se është e vërtetë që ne i jemi drejtuar Kuvendit të Shqipërisë me një letër në emër të 15 organizatave ku, në fakt, nuk kërkonim pjesëmarrjen në konsultime, sepse mendojmë se kjo është e drejta jonë, përkundrazi, ishte një kërkesë për të drejtën informimit, kur Kuvendi në fund të muajt nëntor tha se kishte dy drafte të miratuara, të përmirësuara nëpërmjet ekspertizës së huaj. Kërkesa jonë ishte kërkesë për të drejtë informimi për procedurën e ndjekur nga komisioni juaj lidhur me konsultimin, me kë është kryer ky konsultim dhe kush ka dhënë mendim lidhur me këtë konsultim. Të gjithë ju besoj se keni marrë dy variante, të cilat që në titull, që te mënyra se si janë stivuar ato dy *word*-e, shënojnë që janë drafte të përmirësuara me ekspertizën ndërkombëtare. Por ne ende jemi të paqartë se kush e ka dhënë këtë ekspertizë ndërkombëtare. Asnjë nga 7 organizatat më të rëndësishme në botë për lirinë e medias dhe të drejtat e gazetarëve nuk është konsultuar, përkundrazi, kanë ardhur edhe në Shqipëri dhe kanë dhënë deklaratat të vazhdueshme kundër këtyre dy projektligjeve. Asnjë nga organizatat lokale nuk është konsultuar.

Ekspertiza e huaj dje te Komisioni i Ligjeve tha se është dhënë nga zyra e OSBE-së në Vjenë. Ne nuk e dimë as këtë, sepse përgjigjja zyrtare e zyrës së OSBE-së në Vjenë u publikua vetëm pardje, ndërkohë që drafti juaj i përmirësuar me ekspertizën ndërkombëtare është publikuar më 20 nëntor. Pra, ka shumë paqartësi në proces. Përgjigjja që na erdhi nga Kuvend ishte një refuzim për transparencë.

Për sa i përket Kodit të Etikës dhe vetërregullimit, është e vërtetë. Ajo që theksuan dje ndërkombëtarët, institucionet ndërkombëtare në këtë sallë, në konsultimin me Komisionin e Ligjeve dhe me ne, është që po, ne jemi të vetëdijshëm se si në çdo profesion tjetër, ka problematika, por jemi të angazhuar drejt vetërregullimit, i cili është standardi i vetëm europian dhe bashkëkohor.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Faleminderit, zonjë!

Të njëjtin shqetësim kam ndarë edhe me përfaqësuesen e OSBE-së, zonjën Irina, të cilën e falënderoj për mikpritjen pranë zyrave të OSBE-së. Të njëjtin shqetësim kam shprehur

edhe në Konferencën e Kryetarëve, pasi deputetëve të këtij komisioni pothuajse, gjatë kohës që mendohej se mund të kishim dy draftë të përmirësuar, drafti nuk iu paraqit asnjëherë, mbeti në errësirë. Ndërkohë, puna më diktoi për të zhvilluar seanca dëgjimore të përbashkëta me Komisionin e Ligjeve. Zonja Irina, të njëjtën gjë jua kam pohuar edhe juve. Më është kërkuar të zhvillojmë seanca dëgjimore të përbashkëta, ndërkohë që ne nuk kishim një draft. U kërkuar edhe nga komuniteti i gazetarëve. Kam qenë në errësirë edhe unë, ndaj nuk kam ditur çfarë të komunikoj me ju. Ajo që ju thoni, është e vërtetë.

Milva Ekonomi – Për procedurë.

E para, duhet të kemi parasysh, zonja kryetare, që veprimtaria e komisionit rregullohet në bazë të Rregullores së Kuvendit. Për t’ju sqaruar edhe një herë, ju dje munguat në komision, sepse u caktuat nga Kuvendi me një detyrë tjetër parlamentare në një takim pune në Varshavë. Në këto kushte, sipas nenit 22 të Rregullores, komisionin e drejton nënkryetarja.

Fatjona Dhimitri – Nuk ishte emergjencë për t’u zhvilluar komisioni ditën e djeshme, Milva.

Milva Ekonomi – Mos më ndërprit fjalën!

Fatjona Dhimitri – Autokrati mund të merret shumë mirë me problemet e fatkeqësisë natyrore, nuk ka pse të kalojë me këtë ligj.

Milva Ekonomi – Mos më ndërprit fjalën!

Fatjona Dhimitri – Demokracinë time e mbroj shumë mirë.

Autokratin e kemi mbi krye.

Vazhdojmë.

Milva Ekonomi – Do të vazhdojmë patjetër.

Mundohu të jesh më e përmbajtur dhe më e edukuar në komision!

Fatjona Dhimitri – Jam shumë e përmbajtur, por të flasim për të vërtetën, të mos e lëmë në errësirë.

Është e njëjta gjë që tha edhe zonja.

Milva Ekonomi – Unë po flas për të vërtetën. Ju kishit një detyrë dhe në ato kushte unë mora përsipër të zhvilloj takimin.

E dyta, sikurse edhe ju e dini, ka një mbledhje të Konferencës së Kryetarëve dhe ju, si kryetare e këtij komisioni, jeni e vetmja që uleni në atë mbledhje dhe caktoni kalendarin e veprimtarive të komisionit. Duhet ta dini shumë mirë dhe ta thoni shumë drejt, shumë qartë, se si zhvillohet kjo mbledhje. Pse nuk ishte në rendin e ditës ligji dhe çfarë diskutuat ju me OSBE-në? Ligji kishte nevojë për disa konsolidime juridike, ndaj nuk u fut në veprimtarinë e

Kuvendit. Kjo nuk është vetëm falë meritës së një organizate ndërkombëtare, por edhe falë mënyrës se si punohet dhe bëhet qasja në Kuvend.

Të lutem ...

Fatjona Dhimitri – OSBE-ja kërkonte draftin. Irina është prezent. Unë kam folur me Irinën. OSBE-ja kërkonte draftin. Ku ishte drafti? Këtë çështje e shpalosa edhe në Konferencën e Kryetarëve, kur u kërkua të bëhen seanca të përbashkëta dëgjimore, ndërkohë që deputetët e tjerë nuk e kishin draftin.

Milva Ekonomi – Unë do t’ju sugjeroja ta informonit më drejt edhe publikun për këtë gjë, sepse drafti është një proces i gjatë pune, që ka ndodhur midis Shërbimit Juridik të Kuvendit, midis OSBE-së dhe të gjitha misionëve që ka sjellë OSBE-ja në Shqipëri. Kjo gjë u konfirmua edhe dje nga OSBE-ja. Pavarësisht ndasive që mund të kemi për ligjin, procesi ka qenë konsultativ me Shërbimet Juridike të Kuvendit dhe me OSBE-në. Ju e dini shumë mirë këtë gjë, sepse kemi qenë të dyja në një takim që ka bërë OSBE-ja. Ju lutem ..

Fatjona Dhimitri – Unë nuk kam qenë prezente në takim. Takimin me ambasadorin dhe me Irinën e kam zhvilluar vetë.

Milva Ekonomi – Këto janë diskutime për procedurë.

Fatjona Dhimitri – Nuk ka lidhje fare.

Publiku e njeh shumë mirë të vërtetën. Media e njeh shumë mirë të vërtetën. Ju keni frikë nga e vërteta, kështu që vazhdoni të mbështesni projektligjet tuaja.

Vazhdojmë me zotin Çipa.

Aleksandër Çipa – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zonja dhe zotërinj deputetë, që po na dëgjoni në këtë seancë!

Unë do të doja të përcillja, më së pari, konfirmimin e qëndrimit zyrtar që ne kemi paraqitur në deklaratën që lexoi kolegja.

Dua të sjell në vëmendjen tuaj që, si kurrë ndonjëherë, një nismë e tillë ligjore nuk është përballur me një reagim kaq të unifikuar midis organizatave, që përfaqësojnë spektrin e komunitetit të gazetarëve në Shqipëri dhe organizatave më prestigjioze në botë.

Sjell në vëmendjen tuaj që dy ditë më parë, një ndër gazetatat më prestigjioze në botë, “New York Times”, i referohej nismës suaj, duke ngritur alarmin se ky rast shënon një precedent të rrezikshëm për lirinë e shprehjes dhe për liritë universale në Shqipëri. Pra, siç e shikoni, nuk është vetëm një grup interesi brenda perimetrit kombëtar, por është një grup interesi në nivel global, që është i alarmuar nga kjo nismë e fundit e shumicës qeverisëse dhe që ka mbërritur tashmë në shqyrtimin tuaj si komision.

Ne nuk kemi ardhur këtu vetëm në pozitën e refuzantit. Ne jemi të ndërgjegjshëm që në veprimtarinë dhe në punën tonë të përditshme ka probleme që, fatkeqësisht, janë të bartura në të gjithë harkun kohor të 28 vjetëve të demokracisë. Nëse e keni vënë re, deklarata jonë, në thelbin e saj, ka një adresim. Ne jemi për proceset vetërregulluese dhe jo të jenë prioritare proceset rregulluese. Ajo që përbën një shqetësim të besueshëm për ne dhe në mënyrë të veçantë për opinionin publik, mund të ndryshojë metodologjinë që keni përdorur për hartimin e këtij projektligji, në fakt, të dy projektligjeve në një, dhe për të besuar sa të sigurtë jeni në ambicien tuaj për rregullim. Pse e them këtë gjë?! Ne e ndajmë arsyetimin, që proceset vetërregulluese janë procese të munguara në shumicën e rasteve, sepse ne nuk kemi mekanizma vetërregullues dhe ky është një pohim që buron prej ndërgjegjes sonë profesionale. Çdo ligjbërës shqiptar duhet t'i inkurajojë që në realitetin mediatik të Shqipërisë jo vetëm të mishërohen, por të funksionojnë, pa humbur kohë, mekanizmat vetërregullues, të cilët zgjidhen konform një luajalitetit brenda komunitetit profesional të gazetarëve dhe ju duhet ta kërkonti këtë gjë, në mënyrë që të funksionojnë këto dhe jo të merrni nismën rregulluese, duke lënë dhe duke krijuar alibi për censurën. Kjo është e rrezikshme dhe nuk është e hijshme për demokracinë dhe pluralitetin në Shqipërinë e sotme.

Aspekti i dytë. Në qoftë se ju jeni të interesuar për të pasur prej nesh një recencë juridike për çështje të cilat krijojnë problematika të rrezikshme jo vetëm për censurën, por edhe për privimin e lirisë së shprehjes, në nenet e këtij projektligji që na keni paraqitur, sidomos kur flisni për penaltitetet, ato janë masa financiare të papërbalueshme nga buxhetet e gazetarëve. Them buxhetet e gazetarëve, sepse ndryshe nga mediet tradicionale, mediet e reja përgjithësisht kanë për posedues gazetarët, të cilët asetet financiare dhe të ardhurat financiare i kanë shumë minore në raport me poseduesit e medieve tradicionale. Kjo është diçka që duhet marrë në konsideratë prej jush.

Së dyti, ju keni pretenduar se keni rishqyrtuar pikën e cila lidhet me masën administrative që parashikoni të japë Këshilli i Ankesave i AMA-s dhe, gjithashtu, keni parë që neve na jepet mundësia t'i drejtohem gjykatës, por nuk mund të ekzekutohet vendimi ekzekutiv pa dalë vendimi i gjykatës, sepse kjo është një gjë shumë e rrezikshme, aq më tepër kur ju e dini shumë mirë se çfarë realiteti kalendash ka procedimi administrativ, veçanërisht dhe, aq më tepër, ai gjyqësor në Shqipërinë e sotme.

Në qoftë se ju doni që të flasim edhe për aspekte të tjera të veçanta, të cilat ne i lexojmë si një rrezikshmëri dhe janë shprehimisht alibi për censurim dhe për indulgjenca të autoritetit të pushtetit tjetër mbi pushtetin mediatik, ne mund t'ju ofrojmë shumë fakte të tjera. Prandaj, ne ndajmë arsyetimin e unifikuar që këto dy ligje duhet të anulohen. Këto duhet të anulohen

edhe për arsyen se ju e keni konceptuar, edhe në pikëpamjen e arkitekturës juridike, si një amendim të ligjit për mediat audiovizive dhe keni mbajtur arketipin e dy institucioneve, që ju i quani ente rregullatore, me atributet e rregullimit të tyre, por kjo nuk është funksionale. Prej 28 vjetësh, besueshmëria jo vetëm prej komunitetit të gazetarëve, por prej të gjithë grupeve të interesit ndaj entit rregullator publik, që është AMA, ka qenë kritike dhe jofunksionale në shumicën e rasteve dhe e akuzuar nga raportet periodike, që vlerësojnë në mënyrë të veçantë funksionimin e medias publike dhe entin rregullator publik. Atëherë, përderisa kemi një histori të tillë kaq kritike, si mund t'i ripërsërisim dhe t'i shumëfishojmë atributet rregulluese këtij enti, pavarësisht se i shtohet një departament apo i ndryshohet akronimi i një bordi, pasi dikur quhej Bordi i Monitorimit të Mediave, ndërsa tani quhet Këshilli i Ankesave të Mediave? Kjo nuk është funksionale, nuk mund të funksionojë dhe, mbi të gjitha, do të krijojë precedentë të rrezikshëm, të cilët në vëmendjen time, këtu flas me përgjegjësinë e drejtuesit të organizatës më të strukturuar të gazetarëve në Shqipëri, do të krijojnë probleme me raportet periodike të pritshme të vlerësimit dhe indeksimit të lirisë së medias në nivel global.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri- Faleminderit, zoti Çipa!

Fjalën e ka zonja Ilda Londo, përfaqësuese e Institutit Shqiptar i Medias.

Ilda Londo- Unë jam dakord me ato që u thanë, kështu që të mos përsërisim kot.

Fatjona Dhimitri- Urdhëroni!

Ju lutem, prezantohuni me qendrën që përfaqësoni!

Elvin Luku- Përshëndetje të gjithëve!

Unë jam Elvin Luku dhe përfaqësoj Qendrën Shqiptare “Medialook”.

Zonja kryetare, ju falënderojmë për ftesën!

Dua t'u lutem kolegëve të tjerë që të kenë durimin të na dëgjojnë dhe të mos bëjnë lojëra fjalësh.

Së pari, këto dy drafte e censurojnë drejtpërdrejt median *online* dhe ndikojnë në të paktën 5 aspekte kryesore. Para se të ndaloj tek aspektet kryesore, do të doja që edhe ky komision të mos ishte thjesht formal, sikurse kanë qenë 4 komisionet konsultuese, që janë zhvilluar nga muaji dhjetor i vitit të kaluar deri në fund të janarit, ku një grup organizatash dhe përfaqësues të medias kanë marrë pjesë në takimet e organizuara nga AMA dhe AKEP-i. Aty ne kemi bërë një ekspertizë dhe një analizë të dy draftligjeve, të cilat mund të vërtetohen fare mirë edhe nga zbardhja e deklaratave që publikon AMA. Por ne vëmë re se asnjë nga kritikrat tona nuk është reflektuar në këto dy draftligje dhe më pas, 6 muaj më vonë, vjen një raport i OSBE-së, i cili duhet vlerësuar për punën që ka bërë, por që për fatin e keq në 80% të rasteve

përfshinte kritikën që ne kishim paraqitur që në muajin dhjetor të vitit të kaluar. Pra, minimalisht qoftë qeveria, qoftë vendi ynë, por edhe ne vetë kemi humbur të paktën 6 muaj kohë. Ajo që ne shohim aktualisht, duke parë edhe kritikën e fundit dhe raportin e fundit të OSBE-së, është që sërish ekspertiza finale e OSBE-së nuk është reflektuar në këtë draft.

Unë dua të kaloj në 5 pikat, që në gjykimin tim janë problematike dhe, sipas meje, duhet filluar që të frymë e këtyre dy draftligjeve. Unë jam pedagog i komunikimit dhe gjykoj që problematika fillon që nga momenti kur ti përpiqesh të amendosh një ligj, i cili rregullon mediet e komunikimit vertikal, siç e tha Sandri, dhe me të njëjtin ligj të kontrollosh mediat e komunikimit horizontal, të cilat janë mediet *online*. Nëse duhet të rregullohet sektori i medias *online*, kjo duhet bërë nga komuniteti i gazetarëve, por duhet një ligj i veçantë, sepse nuk mund të jetë në të njëjtin ligj.

Unë i mëshoj shumë vetërregullimit. Pse i mëshoj vetërregullimit dhe pse them që ndoshta duhet të jetë një ligj i veçantë, por i bërë nga gazetarët?! Sepse në këtë ligj nuk merren aspak parasysh disa koncepte të medias *online*, që kanë të bëjnë me gazetarinë qytetare, e cila nuk përfshihet fare, madje ky ligj e censuron. Elementi tjetër ka të bëjë me agregatorët e lajmit, sepse ky ligj i censuron agregatorët e lajmit dhe, së treti, shpeshherë ligji ngatërron konceptin e rrjeteve sociale me mediet online. Domethënë, nuk është fare i qartë, sepse aty nuk jepet përkufizim ligjor se çfarë janë mediet online, rrjetet sociale e të tjerë. Një qytetare e thjeshtë arrestohet, sepse bën një postim dhe ndan një lajm të marrë nga një medie e huaj. Kjo ndodh, sepse ngatërrohet media me rrjetet sociale.

Elementi i dytë. Unë dua të sfidoj qoftë qeverinë, por edhe ata që e kanë hartuar këtë draft. Cili është studimi që ata kanë zhvilluar dhe mbi të cilin kanë ndërtuar këto dy draftligje? Cilët janë ekspertët, me të cilët janë konsultuar, qoftë shqiptarë, qoftë ndërkombëtarë, në momentin e hartimit të këtyre dy draftligjeve, sepse nga informacionet na rezulton se nuk është përfshirë asnjë ekspert, asnjë gazetar e të tjerë?

Së treti, një problematikë që unë shoh te këto dy draftligje ka të bëjë me faktin që krijohet një AMA gjykatë, pra krijohet një institucion, ku agjencisë rregulluese i jepen kompetencat e gjykatës, ku përmes vendimeve të saj arrin t'i gjobisë mediet deri në 20 milionë lekë të vjetër. Këto gjopa janë në formën e titullit ekzekutiv, që do të thotë se ti duhet të paguash një herë gjobën, pastaj të shkosh në gjykatë, por, duke pasur parasysh tregun, si gazetarë që jemi, një medie *online* maksimumi i stafit që ka është 4-5 gazetarë dhe buxheti vjetor i saj është 10 milionë lekë, dhe në momentin që ti i vë gjobë 20 milionë lekë, praktikisht e ke mbyllur këtë media dhe kjo është censurë e pastër në mënyrë indirekte.

Elementi tjetër që unë dua të ndalem janë gjrobat, të cilat janë joproporcionale. Them joproporcionale sepse drafti parashikon që për të njëjtën shpifje gjobitet njësoj si televizioni, ashtu edhe gazeta, kur ne e dimë që dëmi është i ndryshëm. Pra, është njësoj si të taksosh në të njëjtën mënyrë një biznes të madh me një të vogël. Edhe raporti, edhe ekspertiza e fundit e OSBE-së kërkojnë që masat ndëshkuese të jenë në proporcion me audiencën që këto medie kanë.

Elementi i fundit, i cili është po kaq shqetësues, është se të dyja draftet parashikojnë përjashtimin e politikës nga shpifja. Në nenin 53/1 thuhet: “Këshilli i Ankesave refuzon një ankesë, kur çështja objekt ankese lidhet me thëniet gjatë veprimtarisë parlamentare, zhvillimit të seancave gjyqësore apo të respektimit të veprimtarive të subjekteve politike”. Kjo do të thotë se burimin kryesor të shpifjes ne e përjashtojmë nga drafti antishpifje. Kjo është e pakuptimtë.

Unë i bëj thirrje komisionit që për të gjitha këto arsye të marrin në konsideratë qëndrimin e përbashkët të 15 organizatave shqiptare, ekspertizën e OSBE-së dhe qëndrimin e organizatave të tjera ndërkombëtare, të cilat janë me shumë reputacion, siç janë Reporterët pa Kufij dhe Federata Europiane e ajo Ndërkombëtare e Gazetarëve.

Së fundi, dua t’ju bëj thirrje që t’i tërhiqni këto dy draftligje dhe të na jepni mundësinë neve, gazetarëve, që problemet që ekzistojnë dhe që ne i pranojmë që janë të shumta në rrethin tonë, t’i rregullojmë përmes mekanizmave të tjerë.

Ju faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Faleminderit!

A dëshiron ta marrë njeri fjalën nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit?

Nga Qendra “Res Publica”.

Artan Rama - Unë jam Artan Rama, përfaqësoj Qendrën “Res Publica”, por njëkohësisht jam edhe gazetar i pavarur, i paatashuar në ndonjë redaksi apo medie.

Dua të them dy fjalë në lidhje me vetërregullimin, pa dashur të përsëris gjëra që u thanë më parë, për të cilat unë jam dakord plotësisht. Duhet të kuptojmë që vetërregullimi nuk është një proces kaq paqësor sa mund të kuptohet, ai është po aq aktiv dhe po aq i tensionuar sa edhe efekti pozitiv që ai mund të ketë, por vetërregullim nuk do të thotë ndëshkim. Pra, qasja e projektligjit, autor i të cilit është Kryeministri, kam përshtypjen se ai është i vetmi ekspert dhe mirë do të ishte të ishte edhe ai këtu e të diskutonte me ne, është ndëshkimi, është imazhi i keq, por vetërregullimi është një proces edukues, i cili do kohë të ndodhë, por kjo nuk mund të ndodhë vetvetiu. Shoqëria dhe rendi, të cilin ne mbështesim, ka disa mekanizma për ta bërë këtë edukim dhe për t’i dhënë kohën e duhur shoqërisë për të reflektuar, pa ndëshkuar dhe pa kufizuar lirinë e shtypit. AMA, meqenëse është propozuar si një institucion për ta marrë

përsipër, mund ta bëjë fare mirë këtë. Ajo mund të zhvillojë programe edukuese me mediet ose me organizatat. AMA mund të përfshijë organizata të shoqërisë civile, të cilat, në bashkëpunim me komunitetin mund të diskutojnë dhe zhvillojnë projekte në lidhje me problematikat e...

Cili është problemi ynë?! Problemi ynë është gjuha e urrejtjes që ne kemi prezent, mungesa e empatisë dhe e solidaritetit dhe mungesa e njohjes së një raportimi në mënyrë etike. Është e vërtetë që ka shumë gazetarë, të cilët nuk e njohin etikën e raportimit, por, nëse ne zhvillojmë projekte dhe bashkëpunime me komunitetin, me brezin e ri dhe u sqarojmë atyre se cila është kjo problematikë, mund të arrijmë që të kemi një vetërrregullim të suksesshëm, por pa ndëshkuar dhe pa kufizuar lirinë e shtypit dhe të fjalës. Pra, kjo është qasja që duhet të ketë AMA.

A mund të më thoni ju cilat janë projektet që ka zhvilluar AMA në lidhje me edukimin në fushën e medias? Cilat janë komunitetet që AMA ka përfshirë? Ata janë pothuajse inekzistente dhe ajo që propozohet është vetëm ndëshkimi. Ne mund ta rëndojmë Kodin Penal dhe mund të armatosim në mënyrë agresive institucionet e zbatimit të dhunës dhe të ligjit, por ne kurrësi nuk mundet të shmangim fenomenet dhe imazhin e keq vetëm nëpërmjet ndëshkimit. Po marr një shembull nga projektligji që është paraqitur, atë të konceptit të sigurisë kombëtare. Siguria kombëtare garantohet vetëm nga një shtyp i lirë, ndërkohë ky projektligj kufizon lirinë e shtypit për shkak të sigurisë kombëtare, e keni në nenin 132, ku thuhet: “Qeveria merr atributet për t’u përcaktuar si protektor i sigurisë kombëtare”. Asnjë legjislacion dhe asnjë rrethanë ligjore nuk i jep të drejtën qeverisë që të përcaktohet si protektor i sigurisë kombëtare, sepse këtë gjë e zgjidh vetëm gjykata. Po marr një shembull, në qoftë se unë si gazetar, falë një hulumtimi zbuloj se në Elbasan apo Gramsh një fabrikë municionesh tregton armë në një zonë ku zhvillohet luftë, po them Gjeorgji, dhe dua ta publikoj, ne jemi të vetëdijshëm që publikimi i këtij hulumtimi mund të cenojë marrëdhëniet e të paktën 3 apo 4 shteteve dhe qeveria, në bazë të këtij projektligji, më thotë që unë nuk duhet ta publikoj këtë informacion, sepse cenohet siguria kombëtare. Unë po ju pyes ju se cili është vendimi i drejtë që duhet marrë në këtë rast: duhet ta publikojmë informacionin dhe të themi që kemi të bëjmë me një trafik dhe një qeveri mafioze apo duhet të frikësohemi për faktin se po cenojmë sigurinë kombëtare ose raportet diplomatike midis dy apo tre shteteve? Këto janë gjëra që nuk mund t’i zgjidhë qeveria. Natyrisht që qeveria mund të ketë një qëndrim të saj, por kurrësi nuk duhet të marrë një verdikt për këtë, sepse këtë e zgjidh gjykata. Këto janë raste që janë zgjidhur shumë vite më parë nga demokracitë perëndimore. Kryeministri tha që ne duhet të luftojmë lajmet e rreme gjatë emergjencave, por unë mendoj se gjatë fazave të emergjencave ajo që duhet të kontrollohet më shumë është qeveria dhe jo mediet, ndërsa ky ligj bën të kundërtën. Pra, detyra

e medias është të kontrollojë qeverinë dhe kurrësi qeveria të kontrollojë median. Besoj se kjo është e mjaftueshme.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri- Lorin Kadiu, nga “Citizen Channel”.

Lorin Kadiu – Unë jam Lorin Kadiu, përfaqësoj Qendrën “Citizen Channel”, që është një grupim i përbërë kryesisht nga gazetarë të rinj.

Edhe një herë dua t’ju kujtoj faktorët dhe aktorët që janë kundër këtyre dy projektligjeve. Të reflektoni fillimisht për vërejtjet e OSBE-së, Këshillit të Europës, UNDP-së dhe Bashkimit Europian; 7 organizatave ndërkombëtare mbi lirinë e mediave dhe 15 organizatave shqiptare.

Unë, si gazetar i ri, nuk mund të pranoj që media të kontrollohet nga institucione, anëtarët e të cilëve zgjidhen, shkarkohen dhe emërohen sipas preferencave të parlamentit apo të partive politike. Zgjidhja për problemet që ka media sot, siç u përsërit nga të gjithë kolegët, është vetërregullimi. Me këto dy projektligje unë mendoj që dera e vetërregullimit po mbyllet një herë e përgjithmonë. Prandaj dua t’ju ftoj të reflektoni për këto dhe jo për përthyerjet e modeleve letoneze, kroate apo malazeze, të cilat nxirren nga konteksti dhe paraqiten këtu si projektligje.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri - Besoj se u ezauruan dëgjuesat me të gjithë të ftuarit. A keni diçka për të shtuar?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, patjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi- A mund ta marr fjalën?

Fatjona Dhimitri- Një sekondë, Milva, sepse e kërkoi dikush këtu.

Lorin Kadiu- Nëse ka pyetje nga salla, mund të na i drejtojnë.

Milva Ekonomi- Faleminderit që ishit sot me ne!

Dua t’ju sjell në vëmendje që nismat ligjore merren sipas Kushtetutës, vijnë në Kuvend nga Këshilli i Ministrave, nga një grup deputetësh ose vijnë nga një numër i madh përfaqësuesish të popullit. Kështu që edhe po të nisni një iniciativë ligjore, duhet të bashkëpunoni me ne, sepse kjo është fryma e vetme e bërjes së një ligji të mirë. Duhet të bashkëpunoni me Kuvendin për të bërë një ligj të mirë.

Komisioni ka punuar kështu gjithmonë. Ne nuk kalojmë dot një ligj, në qoftë se nuk dëgjojmë ata që janë të interesuar për të. Ne duam të bëjmë një ligj të mirë, që ju shërben edhe

juve, edhe vendit dhe ky është qëllimi që ne kemi. Në përgjithësi ne punojmë me një formë të strukturuar. Kemi parasysh ligjin që vjen nga qeveria, nga deputetët ose nga 20 mijë nismëtarë, i dëgjojmë të gjitha grupet e interesit, i mbledhim të gjitha vërejtjet në një formë tjetër, thërrasim përfaqësues nga Shërbimi i Monitorimeve të Kuvendit dhe Shërbimi Juridik dhe fillojmë e punojmë me juristët për të detajuar këtë. Në fakt, në këtë projektligj nuk është vepruar vetëm kështu, por ka qenë edhe nevoja e ekspertizës ndërkombëtare...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E kemi kërkuar nga shërbimet e Kuvendit, sepse ka një Shërbim Kërkimi, ku mund ta ndaj me ju të gjithë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Rakipi, është bërë një kërkim parlamentar...

(Ndërhyrje pa mikrofon .)

Dua t'ju sqaroj diçka. Ligji ishte parashikuar në muajin korrik dhe për arsye të këshillimeve që duheshin bërë, u tërhoq. Ndërkohë, i jemi drejtuar Kërkimit Parlamentar që të na depozitonte kërkimet e bëra në botën perëndimore. Domethënë, sot në Kuvend ne kemi 3 qasje: ligjin që ka ardhur nga Këshilli i Ministrave, ligjin e përmirësuar me ekspertizë dhe...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Tani jua sjell me *e-mail* raportet...

Fatjona Dhimitri- Në cilin vend perëndimor ka ligje që kufizojnë lirinë e shprehjes dhe të fjalës?! Vetëm në Shqipëri po ndodh kjo.

Milva Ekonomi- Të lutem, a mund ta përfundoj unë? Ndërkohë, tregohuni e ditur dhe e respektueshme për punën që bëjnë anëtarët e tjerë të këtij Kuvendi. Edhe ju, si unë, keni marrë të njëjtin *e-mail* nga Shërbimi i Kërkimit Parlamentar. Keni marrë dy *e-maile*: njërin e keni marrë pardje, ndërsa tjetrin në një periudhë...

Fatjona Dhimitri – Milva, të lutem shumë, mos fyej, ndërkohë që në pozicionin e personit që...

Milva Ekonomi- Unë nuk po fyej.

Fatjona Dhimitri – E fyer është media, e cila po censurohet...

Milva Ekonomi- Kryetare, mos deformato fjalët, por më dëgjo se çfarë po them.

Fatjona Dhimitri- Unë nuk po deformatoj asgjë, por ju po vini në diskutim padijeninë time, ndërkohë që draftet në errësirë i kalon vetë maxhoranca juaj dhe ju e dini shumë mirë këtë gjë. Cili është drafti i ripunuar dhe a është ripunuar ky sipas rekomandimeve të OSBE-së? Ja ku e kemi përfaqësuesen e OSBE-së...

Milva Ekonomi- Draftin e ripunuar e ke në dosje.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në qoftë se ne e kemi këtë gjë në *e-mail*, ju e keni në faqen e parlamentit. Ky është kusht, prandaj punohet kështu. Asnjë gjë nuk shpërndahet nga vëmendja globale e të gjithë të interesuarve. Në qoftë se ne e marrim në *e-mail* këtë gjë, ajo është edhe në faqen e parlamentit....

Fatjona Dhimitri – Milva, boll e mbrojtët këtë masakër në media, boll e mbrojtët!

Milva Ekonomi - Dua t'ju lutem shumë për një gjë, sepse ne jemi duke punuar dhe dëgjesa me ju për ne është shumë e rëndësishme. Në qoftë se e keni kuptuar, për ne kishte....

Fatjona Dhimitri- Sa do të merren parasysh dëgjesat e tyre, Milva?

Milva Ekonomi- Siç janë marrë gjithmonë.

Fatjona Dhimitri- Kur janë marrë parasysh?! U bë ligji për Akademinë e Shkencave dhe asgjë nuk u morr parasysh....

Milva Ekonomi- Ndryshoi totalisht. Jo varianti që more nga Fuga, por ligji ndryshoi totalisht.

Fatjona Dhimitri - Ta kishit për nder të kishit projektligjin e Fugës dhe jo atë të kopjuar të Gjinushit.

Urdhëro, zonja Mimoza!

Milva Ekonomi- A mund të shtoj diçka? Mos ma ndërprit fjalën, kryetare!

Fatjona Dhimitri- Vazhdo, Mimoza!

Milva Ekonomi-Të nderuar gazetarë, dua t'ju lutem për diçka. Në veprimtarinë e këtij komisioni ne kemi disa rregulla dhe rregulli i parë është që duhet të dëgjojmë nismëtarët. Dje ne kemi pasur të ftuar dy grupe që i kemi dëgjuar, nismëtarët dhe ndërkombëtarët, sepse ne mendojmë që këto dy grupe janë shumë të rëndësishme të japin opinionet dhe kemi marrë prej tyre të gjitha shënimet. Ju lutem shumë, edhe shënimet që profesori i komunikimit solli...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatjona Dhimitri- Kjo praktikë ndodh shpesh këtu, që ligjet e kopjuara të qeverisë paraqiten nga nismëtarët.

Milva Ekonomi- Ne vazhdojmë dhe punojmë për këtë ligj. Është në principin e këtij komisioni që të vendosë në fund nëse është një ligj që kërkon shumë ndryshime apo pak ndryshime. Në qoftë se ligji nuk kërkon shumë ndryshime...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatjona Dhimitri- Po, vazhdoni, urdhëroni!

Elvin Luku - Faleminderit!

Zonja Milva tha që të lutem na e sillni ekspertizën. Ne, së pari, e kemi depozituar te AMA, kur kemi bërë konsultimet e para. Por në qoftë se AMA nuk jua ka sjellë, nuk është problemi ynë.

Së dyti, të gjitha janë të publikuara në shtyp që prej dhjetorit të vitit 2018. Në qoftë se ju doni, ju sjellim *linket*, ku vetëm unë kam bërë 10 shkrime për këtë çështje, pastaj Birn Albania, Këshilli Shqiptar i Medies, Unioni i Gazetarëve e të tjerë, të cilët kanë mbajtur qëndrime e deklarata dhe të gjitha kanë qenë të përbashkëta.

Së fundi,

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, janë publikuar. Ju kujtoni se është draft ndryshe, por ai është i njëjti i muajit dhjetor të vitit 2018, ku i kemi reflektuar ne....

Milva Ekonomi- Ka procedurë parlamentare, nuk është njësoj.

Elvin Luku- Unë po them logjika e thelbi dhe nuk po them që kanë hequr një fjalë dhe kanë futur një fjalë tjetër. Fryma e ligjit është e njëjtë.

Fatjona Dhimitri- Po, urdhëroni!

Nga Birn Albania.

Aleksandër Cipa – Unë jam Aleksandër Cipa dhe përfaqësoj Unionin, megjithatë unë kam xhentilesën t’ia jap zonjës fjalën.

Kristina Voko- Faleminderit!

Atëherë, i njëjti presion, ju lutem shikoni komentet nen për nen, ishte dhe dje nga Komisioni i Ligjeve. Kishim dy orë e gjysmë diskutime për të bërë të qartë qëndrimin tonë. Qëndrimi ynë është që këto dy projektligje i refuzojmë në parim. Pra, ne refuzojmë që të jenë dy institucione, të cilat janë të zgjedhura politikisht, të ndikuara politikisht, që të bëjnë kontrollin dhe vlerësimin e përmbajtjes së medias. Ne jemi shprehur shumë qartë që ka shumë problematika brenda, ndoshta mund të jetë edhe si strategji. Nuk jua them ta hedhim poshtë në Kushtetuese, nëse ju vërtetë do e kaloni, por nuk janë atje detajet, problemi është me qëllimin. Këshilli i Europës, BE-ja dhe UN përmes përfaqësuesit të lartë të të drejtave të njeriut, i cili në datën 25 nëntor bëri deklaratë specifike për Komisionin e Ligjeve lidhur me këto dy projektligje, i kërkoi qartësisht këtij Kuvendi që t’i hedhë poshtë dhe t’i rrëzojë, sepse bien ndesh me konventat ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, ku një ndër të drejtat kryesore është liria e shprehjes e kështu më radhë. Kështu që, ju lutem këtë presionin për të shkuar nen për nen, për të pasur rekomandime... Zonja Milva vazhdoi dhe përsëriti duke thënë që do të shikojmë dhe do të vlerësojmë nëse ka nevojë për shumë ndryshime apo për pak ndryshime. Ne i kërkojmë, vazhdojmë e përsërisim, i kërkojmë Kuvendit t’i hedhë poshtë dhe t’i rrëzojë

dy institucione të zgjedhura politikisht, të vlerësuara që nuk kanë arritur funksionin e tyre, qoftë edhe aktual, minimal, që kanë në të gjitha raportet ndërkombëtare. Nuk mund të jepen funksione shtesë përtej kompetencave aktuale, përtej rregullimit të frekuencave, që është një e mirë publike dhe duhet të rregullohet, sepse është e vetmja mundësi që ju jepet përmes Kushtetutës së Shqipërisë, ku thuhet: “Qeveria mund të rregullojë frekuencat”, por nuk thuhet askund që mund të rregullojë ose të kontrollojë medien. Kështu që po i tejkaloni të gjitha kompetencat, duke rregulluar medien *online* përmes AMA-s dhe përmes AKEP-it. Unë shpresoj që kjo thirrje të jetë e qartë. Besoj se reflektimet dhe thirrjet që ka bërë dje Këshilli i Europës, deklaratat publike që kanë bërë ambasadori i BE-së dhe ambasadorë të vendeve të tjera të akredituar në Shqipëri, të jenë të qarta. Asnjëri nuk ka kërkuar korrigjime, asnjë nuk ka kërkuar arnime. Po, është e vërtetë që zyra e OSBE-së ka thënë se ka nevojë për shumë përmirësime. Asnjë nga aktorët e tjerë nuk ka thënë se ka nevojë për përmirësime. Të gjithë aktorët e tjerë kanë thënë që janë të papranueshme dhe duhen hedhur poshtë.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Faleminderit!

Urdhëroni!

Aleksandër Çipa – Pse duhet ta zgjasim kaq shumë këtë çështje, përderisa ne në mënyrë të unifikuar ju themi se këto dy projektligje duhet të refuzohen? Ju po na shtyni në një ngasje për t’u marrë me detaje, të cilat mund të jenë një arsye për arnime. Ne nuk jemi për arnime të këtyre dy projektligjeve. Ma do mendja se lexohet një vullnet shumë pozitiv profesional yni, kur ne ju themi: po, ju mund të vendosni afate për mekanizmat ekzekutivë vetërregullues, të cilët mungojnë në realitetin medietik të Shqipërisë. Si ligjbërës, mund të vendosni afate për mekanizmat vetërregulluese. Kjo shpreh nismën më pozitiviste të mundshme, nëse ju jeni të interesuar për funksionimin e cilësishëm të lirisë së medias në Shqipëri. Ne kemi një liri të pacilësishme të medias në Shqipëri dhe ky është një pohim i ndërgjegjshëm. Ne nuk jemi në një dispozitë vetëm refuzuese, por edhe sugjeruese, duke na futur në ngasjen e diskutimit të neneve të këtij drafti, që janë dy projektligje në një, ju nuk bëni gjë tjetër veçse na jepni një atribut të pameritueshëm për ta arnuar këtë draft, që e keni qëllim në vetvete.

Ju lutem, edhe kolegëve, nuk kemi arsye pse ta vazhdojmë më diskutimin për këtë çështje, nëse më pas do t’i ndani qëndrimet e spektrit organizatave që përfaqësojmë.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri Faleminderit!

Urdhëroni!

Ylli Rakipi – Në këtë kohë, në vendin ku jetojmë ne e kemi shumë të qartë se sa fuqi keni ju, por, nëse keni mundësi, bëni çfarë të mundni.

Moza Koçiu – Ja që e zbutët edhe Yllin!

Për të përsëritur atë që tha Artani, nuk është detyrë e qeverisë të rregullojë medien, është media ajo që kontrollon qeverinë. Ky është parim botëror që funksionon në çdo vend të botës. Nuk mundet zyra Kryeministrit të vendosë se si do të jetë kontesti i medieve. Kodi Penal i ka nenet e përcaktuara dhe ka edhe gjopa të majme, madje që janë të dhimbshme për ne. Pra, për këdo nga ne që abuzon me detyrën, shpif apo publikon *fake news*, madje është edhe për medien *online* është Kodi Penal, sepse është bërë ndryshimi, ekziston mekanizmi rregullues.

Për sa u përket modeleve ndërkombëtare, ju ftoj edhe një herë të shikoni deklaratën që ju kemi shpërndarë, faqja 6: Federata Ndërkombëtare e Gazetarëve. Janë gjashtëqind mijë gazetarë, më shumë se sa ka anëtarë çdo parti politike në Shqipëri. Janë nga 140 vende të botës. Mendoni se ka shpëtuar ndonjë vend demokratik nga Federata Ndërkombëtare e Gazetarëve që na mbështet ne dhe nuk e shikon si model të hasur apo që duhet bërë?! Prandaj po ju them: unë kam 22 vjet gazetari, Ylli ka shumë më tepër, Sandri gjithashtu. I kemi kaluar këto procese që më '98-ën, kur ka filluar ligji për medien elektronike. Musai e mban mend, se ai është memorie, ju të tjerët jeni shumë më mbrapa, që i kemi kaluar si procese, por asnjëherë nuk ka ardhur propozimi nga zyra e Kryeministrit si këtë herë dhe mediet kanë qenë bashkë, kanë qenë të gjithë aktorët politikë dhe medietikë. Musai mund të ma konfirmojë sërish. I mban mend Musa që kanë qenë të gjithë aktorët, pronari i “Top Channel”, i “Klan”, pra të gjithë janë angazhuar dhe kanë rënë dakord. Pra, është ai ligj, të cilin e respektojmë të gjithë. Korrigjohet në momente të caktuara, dakord, por te kontenti i medieve nuk mund të hyni, sepse nuk është detyra e politikës, as e parlamentit, e qeverisë akoma më keq, sepse ka konflikt interesi që në parim.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Faleminderit!

Të nderuar të ftuar, sugjerimet tuaja në lidhje me projektligjin, ju lutem t'i dërgoni pranë shërbimit të komisionit tonë me shkrim. Uroj që dëgjesa e sotme të merret parasysh, së pari, nga Kryeministri, nga maxhoranca për t'i rrëzuar të dyja këto projektligje.

Uroj që zëri i komisionit tonë të bashkohet me zërin e komunitetit të gazetarëve.

Faleminderit për prezencën tuaj! Do të dëgjohemi sërish!

(Diskutime pa mikrofon.)

(Të ftuarit largohen.)

Adelina Rista – Jo unë, por të gjithë si komision kemi respekt për pozicionin e drejtimit të seancës. Ju jeni kryetare sot, por mos e quani privilegj kryetarllëkun e komisionit, por një detyrë që duhet ta ushtroni me shumë kompetencë, me shumë seriozitet, me shumë edukatë, me shumë tolerancë dhe, mbi të gjitha, me shumë qetësi dhe vetëpërmbytje. Keni një peshë të madhe përgjegjësie si kryetare e komisionit. Seancat janë *online*, janë të hapura. Ju përcillni një model aty që duhet t’ju nderojë ju, duhet të nderojë edhe këtë komision, sepse jemi Komisioni i Edukimit. Unë do t’ju lutesha që në drejtimin e seancës të keni parasysh Rregulloren. Askush nga ata që janë thirrur në dëgjese nuk flet pa ia dhënë fjalën ju. Këtë e ka Rregullorja. Absolutisht jo. Ne i kemi thirrur për t’i dëgjuar dhe do t’i dëgjojmë deri në sekondën e fundit, deri në fjalën e fundit, të mos u ngelet asnjë merak pa thënë, e kemi këtë durim, por, ju lutem, me qetësi dhe tolerancë dhe pa fyer askënd, as ne ata, as ju ne dhe as ne ju. Ky është modeli që duhet të përcjellim. Do t’ju lutesha, e kam si një këshillë, sepse jam më e madhja në moshë nga femrat, më tepër qetësi dhe vetëpërmbytje.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Faleminderit, Adelina!

Ne këto gjëra, pak a shumë, i kemi biseduar edhe privatisht. Besoj se kam treguar një tolerancë dhe një mirëkuptim tepër të madh këtu, e kam dhënë fjalën dhe e kam respektuar Rregulloren në maksimum, por nuk toleroj askënd të më ndërhyjë në momentin që unë flas, pasi për procedurë ia kam dhënë fjalën kujtdo që e ka kërkuar, madje kam pyetur: “E dëshiron ndokush fjalën tjetër, veç meje?!”. Gjithsesi...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Megjithatë, në këtë komision, si në të gjithë qeverinë, është krijuar një lloj precedence që të largohemi nga thelbi i çështjes dhe të merremi me kulturën dhe edukatën e tjetërkujt. E kam të transmetuar nga familja ime atë gjë, një familje shembullore dhe model. Kështu që vijojmë me rendin e ditës.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Çfarë do të thuash?

Urdhëroni!

Bujar Çela – Faleminderit!

Kam shumë respekt për atë karrige. Fjalët që tha Adelina nuk ishin rastësi, ishte mendimi i një pjesë të mirë tonë, por unë dua t’i uroj kësaj vajze edhe 100 vite të tjera, sepse ka pasur ditëlindjen.

Fatjona Dhimitri – Edhe 100 vjet të bëhesh dhe sa të duash!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Aspektin njerëzor e ndaj nga aspekti profesional.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mirela, ta jap unë fjalën për procedurë.

Urdhëroni! Ta shmangim ironinë me njëri-tjetrit, sepse, po të jetë puna për ironi, e hedhim topin dhe e kalojmë.

Mirela Kumbaro – Zonja kryetare, e dashur Fatjona...

Fatjona Dhimitri – E dashur Mirela...

Mirela Kumbaro – Në fakt, dua të respektoj Adelinën, sepse e tha shumë qetë dhe shumë mirë, por, për sa kohë jemi mes nesh, është e vështirë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kur them, zonja kryetare, nuk e kam fare me ironi, madje më fyeni nëse më thoni që unë këtë e them për ironi.

Fatjona Dhimitri – Ti je i vetmi person, me të cilin nuk dua të debatoj, Mirela, për shkak të faktit se ne përfaqësojmë edhe të njëjtën zonë.

Mirela Kumbaro – Zonja kryetare, nuk më shkon ndër mend të zihem me ju. Ende nuk jam zënë në jetë, me të gjitha vitet që kam. Nuk ka ardhur dita të zihem. Kur të ndodhë, do ta bëj publike. Pjesën tjetër unë e quaj debat dhe shkëmbim mendimesh. Për hir të së vërtetës, sidomos kur jemi në publik, sidomos kur kemi të ftuar, sidomos kur kemi media, sepse e konsideroj se ne jemi një lloj familjeje brenda komisionit, le të biem dakord edhe miqësisht, jo vetëm në respekt të Rregullores, të kemi disa rregulla komunikimi.

Së pari, në respekt të Rregullores, por edhe sepse e konsideroj si një familje. Besoj se asnjëri nga ne, ju si më e re, por edhe disa të tjerë që janë në moshën time dhe mbi mua, sepse bëj pjesë të pjesa më e moshuar e komisionit, nuk kemi nevojë që t'ia ndërpresim fjalën e njëri-tjetrit për të rënë në sy as të medieve, as të të ftuarve.

Personalisht, disa herë, kur ma jepni ju fjalën, jo se më bëni ndonjë nder, por sepse jua jep Rregullorja detyrën që të më jepni mua të drejtën e fjalës, në momentin që them diçka, sigurisht që ju nuk jeni dakord politikisht, sepse prandaj jeni në opozitë dhe ne jemi maxhorancë, është krejt normale që të mos jeni dakord dhe që të mos biem dakord, por nuk e zgjidhim dhe nuk tregojmë mosdakordësi, duke ma ndërprerë fjalën mua. E thashë “mua”, sepse këtë e kam me provë, por atë që ju bëtë sot me nënkryetaren dhe, njëkohësisht, mikeshën dhe shoqen tuaj, por edhe tonën, Milvën, e gjej totalisht të pavend. Ju kërkoi fjalën dhe ju mund të mos jeni dakord, por nuk keni të drejtë, dhe më pas biem dakord të dyja, nuk duhet t'ia ndërpresim fjalën njëra-tjetrës, një herë, pastaj, pa diskutim, edhe njëri-tjetrit. Në qoftë se ne gratë ia ndërpresim fjalën njëra-tjetrës, kemi dhënë modelin më të keq për atë që duam ta

quajmë emancipim. Kur ne e bëjmë këtë në parlament, domethënë në Kuvend, që është vendi i fjalës, imagjino çfarë modeli japim ne te njerëzit! Kjo shoqëri ka një problem shumë të thellë me komunikimin dhe ky nuk është as faji juaj, as im. Ky është faji i historisë, i mungesës së shkollimit, pra janë disa faje që shkojnë përtej nesh. Por, të paktën ne, për aq sa jemi në këtë detyrë dhe për aq sa jemi në profesionet tona, të kemi mundësinë, sikur një pikë në oqean, të japim një model komunikimi. Mund të mos biem gjithë ditën dhe gjithë natën dakord politikisht, ndërkohë që mund të jemi mikesha shumë të mira, dhe unë e di që jemi mikesha shumë të mira, së pari, ne të dyja, por edhe të tjerët në këtë tryezë, sepse janë të gjithë njerëz të nderuar, t'i japim fjalën njëri-tjetrit. T'ia ndërpresim fjalën njëri-tjetrit se nuk biem dakord, nuk ka! Unë mund të mos jem dakord, por nuk ju ndërpres. Pastaj ju ndërprisni, ne ndërpresim dhe nuk merret vesh. Ju lutem, të krijojmë një model që, në fakt, ky komision e ka pasur dikur. Jam këtu në mandatin e dytë. Në mandatin e parë përsëri nga një opozitar drejtohej, por kishte tjetër... Në mandatin e dytë e kemi cenuar ca. Unë dhe ju, si drejtuesja e tretë e këtij komisioni që kam njohur, mund ta bëjmë edhe për shkak të zonës nga vini, Përmetit, që për mua është zona më e jashtëzakonshme në Shqipëri. E dimë që mund ta bëjmë, vetëm na mjafton pak vëmendje.

Faleminderit shumë, e dashur!

Fatjona Dhimitri – Unë ju falënderoj ju!

Jua thashë dhe po e ripërsëris, ndërprerje e fjalës ndodh vetëm kur nuk respektohen të drejtat e pjesëmarrësve në seancë.

Pikërisht, nuk janë fare të nevojshme insinuata të tilla, Mirela.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në fakt, mua më duket si ai projektligji i medias që u soll këtu me një shpejtësi të madhe, për të shmangur vëmendjen nga probleme të tjera. E njëjta gjë po ndodh edhe këtu: po diskutojmë për Rregulloren, ndërkohë që përsëri po shmangim vëmendjen nga ajo që është kryesorja, për të cilën jemi mbledhur këtu. Këto gjëra mund t'i diskutojmë edhe jashtë këtij ambienti, në qoftë se ka probleme. Kështu që nuk ka kuptim!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatjona nuk bën asgjë për të bërë show përpara medieve, absolutisht nuk e kam pasur kurrë këtë qëllim. I kam respektuar vendimet dhe mendimet tuaja, ashtu sikurse kërkoj edhe nga ju t'i respektoni mendimet dhe vendimet e mia.

Tani do të vazhdojmë me rendin e ditës.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Urdhëro, se kam ca kohë që nuk ta kam dëgjuar zërin!

Musa Ulqini – Zonja kryetare, unë mendoj se duhet ta kuptosh shumë mirë që ka qenë një vendim shumë i mençur i maxhorancës disa vjet më parë, që postin e këtij komisioni t'ia jepte në të gjitha rastet opozitës.

Së dyti, dua të sugjeroj, dhe nuk dua të bie në rolin e njeriut që abuzon me vjetërsinë, me përvojën dhe me historinë, e përdor shumë rrallë dhe asnjëherë nuk e kam si argument...

Fatjona Dhimitri – Ju kërkoj ndjesë që po jua ndërpres fjalën, por nuk dua më diskutime për Rregulloren!

Musa, mblidhuni vetë dhe diskutojini këto.

Musa Ulqini – Unë për Rregulloren kam të drejtë të flas.

Fatjona Dhimitri – Të lutem, jemi këtu për të diskutuar për tjetër çështje! Sa herë e keni shkelur ju Rregulloren, ligjin e këtij shteti, aq të mira qofshin!

Musa Ulqini – A ka mundësi që ta mbaroj fjalën?!

Unë dua të sugjeroj vetëm një gjë, zonja kryetare, që të pyesni, të shfletoni ndonjë nga këto dokumentet që janë këtu në parlament dhe të kuptoni, në të mirën tuaj, se si e ka drejtuar këtë komision zoti Uran Butka, që vinte nga një shtresë e persekutuar; si e ka drejtuar këtë komision zoti Theodhori Bej, që përfaqësonte një qytetari të tejskajshme si deputet; si e ka drejtuar zoti Pollo, që përfaqësonte një kulturë të spikatur, të bashkangjitur me shumë ironi, por me shumë qetësi dhe maturi; si nuk e ka drejtuar zonja Vokshi; nuk po them si e ka drejtuar zoti Lalaj, si e ka drejtuar Bardhyl Londo, si e ka drejtuar Valentina Leskaj apo unë.

Fatjona Dhimitri – Musa, të mos përmendim emra. Respekt për të gjithë drejtuesit e këtij komisioni dhe të komisioneve të tjera.

Të lutem, Musa, nuk ka kuptim ajo që po thua!

Musa Ulqini – E mbarova. Të sugjeroj...

Fatjona Dhimitri - Çdokush prej nesh përfaqëson një model ndryshe të drejtimit. Nuk ka lidhje.

Musa Ulqini – Të sugjeroj...

Fatjona Dhimitri – Patjetër e ndjek modelin e tyre dhe e kam për nder të ndjek modelin e tyre!

Musa Ulqini – Do të kisha një keqardhje të madhe që ju këtu, pa arsye, të manifestoni në sjelljen tuaj gjërat më të këqija që këta persona i kanë refuzuar dhe...

Fatjona Dhimitri – Të këqija, sepse nuk ju pëlqejnë juve. Të lutem, Musa, do të vazhdojmë me rendin e ditës?!

Musa Ulqini – Bëj një model.

Fatjona Dhimitri – Model i kam për drejtimin tim, i respektoj dhe i vlerësoj shumë. Të lutem, mos më përmend emra, mos personalizo, mos kalo në emra në komision!

Musa Ulqini – Mos u fut te modelet e këqija.

Fatjona Dhimitri – Musa, të vlerësoj ndryshe. Të vlerësoj për urtësinë dhe qetësinë tënde. Më mirë të mbaheni mend kështu.

Musa Ulqini – E keni këtë shans.

Fatjona Dhimitri – Të lutem, rendin e ditës.

Ditën e sotme, në orën 11:00, ishte parashikuar seanca dëgjimore me shoqatat e shoqërisë civile dhe të drejtat e njeriut: me Institutin për Studime Gjyqësore Kushtetuese, i ftuar ishte zoti Fehmi Abdiu; nga shoqata “Grupi shqiptar i të drejtave të njeriut” zonja Elsa Ballauri; nga CRCA-ja zoti Altin Hazizaj; nga Lëvizja Europiane, Gledis Gjipali; nga Instituti për Kërkim dhe Alternativa Zhvillimi, zoti Auron Pasha; nga Qendra “Altri”, zonja Eda Bisha dhe nga “Soros” zoti Andi Dobrushaj. Nuk është paraqitur asnjë nga shoqatat e shoqërisë civile dhe të drejtave të njeriut? Shërbimet e komisionit, a janë njoftuar sipas procedurave të njoftimit në komision shoqatat?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Janë njoftuar me *e-mail*! Si ka mundësi që asnjë prej tyre nuk është paraqitur?! Sapo kam komunikuar me përfaqësuesit e CRCA-s. Kishin dëshirë të vinin, por për shkak të axhendës së tyre, pamundësia nuk i ka lejuar të vijnë sot në komision. Nëse ju dëshironi, seancën dëgjimore me shoqatat e shoqërisë civile e shtyjmë për një ditë tjetër? Këtë do t’jua kërkoj edhe ju personalisht. Nuk është e nevojshme që projektligji të kalojë me një shpejtësi kaq të madhe. Ju thashë edhe një herë që kemi probleme ende më të rëndësishme sesa të merremi me paketat antishpifje.

Milva Ekonomi – Tani, problemet më të rëndësishme sesa të merremi me paketën antishpifje, nuk i vendosni dot ju, zonja Kryetare, as unë, por këto probleme i vendos Këshilli i Ministrave, që e kemi vendosur në krye të vendit që të drejtojë Shqipërinë. Kështu, kur vijnë vendimet nga qeveria, Konferenca e Kryetarëve, ku ju bëni pjesë, ulet dhe diskuton për kalendarin e punimeve. Prandaj nuk mund të jeni vetëm ju një zë që e vendosni këtë. Duhet të merrni pjesë në mbledhjen Konferencës së Kryetarëve dhe të na sqaroni edhe ne, anëtarëve të komisionit, se si do të veprohet. Kështu që këtë informacion merreni mbrapsht dhe mos i përfshini anëtarët në këtë lloj diskutimi.

Së dyti, ne në komision, ngaqë ky ligj është sensitiv, kemi marrë disa herë të njëjtin vendim. Vendimi që kemi marrë, ka qenë i renditur në këtë mënyrë: fillimisht, do të dëgjonim hartuesit e projektligjit dhe organizatat ndërkombëtare që kanë punuar me hartuesit, më pas do

të dëgjonim operatorët e interesuar drejtpërdrejtë në këtë proces dhe ne kështu vepruam. Thamë që në prioritetin e atyre që vijnë si palë të interesuara të shoqërisë civile, do të vendosim një rend. Në rendi të parë janë ata që ishin shkruarit letrës, të cilët ishin thirrur sot këtu; në rend të dytë janë ata të shoqërisë civile që janë të regjistruar në *web-in* e Kuvendit, për të treguar që Kuvendi funksionon sipas rregullave; prioriteti i tretë është që, pasi të mbarojmë dëgjuesat me botën akademike, ku dje ne bëmë shumë kujdes që të vendosim të thërrisim nga bota akademike jo njerëz individualë, por të thërrisim nëpërmjet fakulteteve dhe dekanateve, që ishte shumë e rëndësishme, të bënim një dëgjuesë me një grup të katër profesionistësh që vinin nga shoqatat e medieve, sepse nuk na takon neve që të marrim përsipër të vendosim emra për këtë gjë. Në qoftë se do të biem dakord që në shoqatat e medieve do të ketë dhe të tjerë nga shoqëria civile, që kanë mbetur pa u dëgjuar, do të biem dakord, por të biem dakord për Altin Hazizajn më vete, nuk besoj se do të biem dakord kurrë!

Fatjona Dhimitri – Nuk thashë që të vijë zoti Altin Hazizaj më vete.

Milva Ekonomi – Nuk besoj se do të biem dakord kurrë, sepse kjo gjë dje na mori gjysmë ore diskutim dhe refuzuam përfaqësimin personal të njerëzve këtu. Ramë dakord të gjitha palët dhe kërkuam që të vijnë shoqatat. Ata e dinë vetë se kë sjellin për këtë gjë.

Fatjona Dhimitri – Ne nuk mund ta kalojmë me një shpejtësi kaq të madhe ligjin, pa u dëgjuar të gjithë aktorët e interesit.

(Diskutime pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Aktor interesi është CRCA-ja.

Fatjona Dhimitri – Nuk po them vetëm CRCA-ja. Për shembull, Instituti për Studime Gjuhësore. Kanë nevojë që të vijnë të gjithë.

Milva Ekonomi – I kemi thirrur, por nuk pranojnë të vijnë. Ne i kemi thirrur të gjithë dhe nuk duan të vijnë. Ne, si komision, e kemi bërë detyrën. Hajdeni t'i dëgjojmë ata që duan të japin mendim, të ulemi dhe të punojmë nen për nen, sepse ka punë.

Fatjona Dhimitri – Milva, nuk është më mirë që të uleni dhe të reflektoni, sipas propozimeve edhe të të ftuarve sot, përpara se ne të vijojmë punën ditë pas dite këtu në komision? Nuk është e nevojshme...

Milva Ekonomi – Këtë gjë hidhe në votë. Në qoftë se ti nuk ke marrë një opinion nga...

Fatjona Dhimitri – Unë hedh në votë, por jo të bëheni të gjithë ushtarë dhe t'i bindeni vullnetit të autokratit.

Milva Ekonomi – Na lërë të shprehim vullnetin tonë. Autokrati është forma e drejtimit të procedurave administrative.

Fatjona Dhimitri – Ai urdhëron. Do t'i bindemi tani Taulant Ballës për çdo projektligj që sjell këtu?!

Milva Ekonomi – Në këtë rast do të zbatosh një procedurë administrative të autokratit, që është Rregullorja e Kuvendit.

Fatjona Dhimitri – Procedurë administrative të diktuar nga qeveria. Milva, çfarë po thua?!

Milva Ekonomi – Autokrati në këtë rast për ty është Rregullorja e Kuvendit. Do të lutesha shumë veprimtarinë e këtij komisioni drejtoje sipas Rregullores. Dje diskutuam dhe ramë dakord për këto gjëra.

Fatjona Dhimitri – Nuk është shkelur asnjë nen në Rregullore.

Milva Ekonomi – Të ishit shumë të kujdesshëm që mos thërrisni individë, por shoqata...

Fatjona Dhimitri – Kur drejtohet nga pala juaj, normal pa asnjë problem do të jetë komisioni. Pse? Të gjitha ligjet që sillen prej jush, miratohen prej jush. E keni numrin e votave, vazhdojeni. Çdo ligj i sjellë nga qeveria është perfekt për ju.

Milva Ekonomi – Kështu ka vendosur sovrani.

Fatjona Dhimitri – Po, keni votën, kjo është diktatura. Merrni dhe ca nga votat e opozitarëve që keni sjellë dhe boll i keni.

Milva Ekonomi – Çfarë është kjo diktaturë me votë? Demokracia në fund funksionon me vota. Kështu që unë do të bëja shumë kujdes, sepse ne dje këtë gjë e evituam, evituam emrat personalë. Thamë që do të punojmë me shoqata. Të gjithë ishim në një mendje, sepse thamë që ne nuk duhet të futemi në konflikte që nuk na takojnë.

Fatjona Dhimitri – Të lutem, Milva, unë refuzoj që ta hedhim sot në votë, pra nëse do të zhvillohen apo të ndërpriten dëgjесat me shoqatat e shoqërisë civile.

Milva Ekonomi – Ne do të vazhdojmë...

Fatjona Dhimitri – Vazhdojeni punën, sepse vetë e bëni kalendarin, vetë e miratoni.

Së dyti, sot jam njoftuar në lidhje me diskutimin nen për nen të buxhetit. Kërkoj kohë për të kaluar në diskutimin nen për nen të buxhetit. Nuk mund të diskutohet sot, të merret vendimi sot për sot dhe të diskutohet po sot buxheti. Çfarë po bëhet kështu?! Është absurd! Realisht mua më vjen turp që të jem pjesëmarrëse në komision sot, të mos dëgjohen të gjithë aktorët e interesit, pavarësisht se ata nuk janë përgjigjur sot. Nuk e di cila është arsyeja që nuk i janë përgjigjur?!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të jap unë dorëheqjen?! Po ik ti, mbase prezenca jote nuk është e dëshirueshme! Do të na mësosh ti të japim dorëheqjen?! Kush je ti? Mos u bëj qesharak!

Milva Ekonomi – Zonja kryetare, nëse doni, hidheni në votë, sepse ne dje vendosëm...

Fatjona Dhimitri – Jo, jo unë nuk hedh në votë asgjë, për mua vazhdoni.

Milva Ekonomi – Ti nuk e vazhdon dot këtë mbledhje kështu.

Fatjona Dhimitri – Vazhdojeni e bëjeni ju. Për mua sot është absurde, Milva, që të kaloj në diskutimin nen për nen të buxhetit.

Milva Ekonomi – Ne dje e diskutuam dhe e hodhëm në votë që sot do të bëjmë dëgjese me...

Fatjona Dhimitri – Çfarë hodhët ju në votë?! Votë me votat tuaja, sepse kështu i bie! Diskutim me njerëzit tuaj.

(Diskutim pa mikrofon.)

Ku e kishit opozitën këtu? Unë dje nuk kam qenë këtu.

Atëherë, të shtyhet mbledhja e komisionit. Pse është e nevojshme, se doni ju të kaloni ligjet tuaja një për një?!

Mirela Kumbaro – Kërkoj fjalën për procedurë.

Fatjona Dhimitri – Nuk ka fare për procedurë. Mos na hapni barkun. Këtu bëhen vetëm budallallëqe!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mirela Kumbaro – Fjalën “gënjeshtër” dhe fjalën “budallallëqe” ...

Fatjona Dhimitri – Mirela, të lutem!

Mirela Kumbaro – Edhe unë po të lutem.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatjona Dhimitri – Vazhdoni zhvilloni ...

Musa, të lutem!

Mirela Kumbaro – Fatjona, edhe unë të kërkoj falje!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatjona Dhimitri - Jo, jo, turpërohu për njerëzit e palës tënde, jo për mua! Për veten time unë jam vetë zot, vetë shkop.

Mirela Kumbaro – Fatjona, edhe unë të kërkoj ndjesë!

Fatjona Dhimitri – Turp!

Mua sot më ka ardhur një mesazh për të bërë diskutimin nen për nen për buxhetin. Si mund ta bëjmë sot ne diskutimin nen për nen për buxhetin?!

(Largohet Kryetarja e Komisionit, zj. Dhimitri.)

(Drejtimitin e mbledhjes e merr zëvendëskryetarja e Komisionit, zonja Ekonomi.)

Milva Ekonomi – Shokë, a mund të diskutojmë diçka? Dje ne ramë dakord që ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mbledhja me shoqërinë civile quhet e bërë, sepse ndërkohë ne e thirrëm.

Do të mbarojmë dëgjuesën me botën akademike dhe pastaj do të shikojmë kush ka ngelur i paftuar nga ata që janë përfaqësues të shoqërisë civile dhe të botës akademike. Siç ramë dakord, do të bëjmë një dëgjuesë me ata që nuk kanë qenë të ftuar. Jeni dakord që të vazhdojmë me këtë gjë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Erion Piciri – Diskutimi i buxhetit nuk besoj se ishte sot në rend dite, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mos u mërzisni!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ligji i medias ka një rëndësi të madhe dhe duhet të vazhdojnë të gjitha dëgjuesat. Unë e kuptoj fare mirë që ju keni votat dhe kjo është jashtëzakonisht mirë. Sartori thotë: “fituesi i zgjedhjeve është minoriteti më i madh”. Meqenëse minoriteti më i madh ka votat, të paktën të dëgjojmë maxhoritetin e shoqërisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Maxhoriteti i shoqërisë janë përfaqësuesit e spikatur të shoqërisë, të cilët, siç po shihet, në një pjesë të madhe e kundërshtojnë. Prandaj është shumë e rëndësishme të dëgjojmë edhe mediat. Ju keni votat, por të paktën zërin dhe këtë atmosferë ...

Në një formë të tillë ju keni votat sot, por ne krijojmë votat e nesërme dhe ndryshimin e shoqërisë. Prandaj duhen dëgjuar të gjithë njerëzit

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të japim disa ide se ku po shkojmë.

Milva Ekonomi – Dje ne bëmë një kujdes shumë të madh dhe duhet t’i themi vetes “sa mirë që bëmë diskutimin dje”. Kishim bërë një listë me të ftuar gazetarë, sepse thamë që ligji është shumë sensitiv dhe ne duhet t’i thërrasim të gjithë, por ngaqë është sensitiv duhet t’i ndjekim shumë mirë rregullat. Duhet të thërrasim gazetarët, shoqërinë civile dhe akademikët. Kur ngelen jashtë ata që duan të marrin pjesë te kjo gjë, duhet të bëjmë një thirrje speciale për ata që nuk kanë mundur të vijnë, sepse duhet të jenë të gjithë. Në vend që të jenë personalisht, do të shikojmë emrin e shoqatës dhe do të thërrasim shoqatën. Merakun që keni ju tani, e kishim edhe ne dje dhe këtë vendim morëm.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dëgjesa ka deri të premten.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E vetmja gjë që ndodhi si ndryshim ishte që ne e kishim lënë mbledhjen për diskutimin nën për nën të projektbuxhetit, që edhe zoti Bela kërkoi ...

Pra, e lamë për sot në orën 14:00 për efekte kohore, por meqenëse të ftuarit nga shoqëria civile nuk kishin ardhur, sekretarja e komisionit, bëri lajmërimin që të afrohet takimi për në orën 13:00. Kaq është diferenca që ka ndodhur nga dje sot.

(Diskutim pa mikrofon.)

Ta regjistrojmë.

Muhamet Bela - Nga Komisioni i Ekonomisë dhe Financave ka ardhur njoftimi përmes sekretarisë që brenda datës 9 dhjetor komisionet duhet të dorëzojnë raportin e shqyrtimit nën për nën dhe në tërësi. Kjo ishte arsyeja që i sugjerova edhe dje zëvendëskryetares për të bërë mbledhjen për buxhetin. Gjithsesi, ju jeni kompetentë që vendosni për këto punë.

Kostaq Papa – Gjithçka që ndodhi sot në lidhje me regjistrimin për çfarë do të bëjmë u bë dje gjatë mbledhjes për efekte kohore. Meqë koha është e ngjeshur dhe kemi shumë dëgjesa ... Bile u mendua që do të bënim dëgjesa të shtunën dhe të dielën. Për të mos punuar edhe në këto dy ditë, po përpiqemi të afrojmë oraret që t'i mbarojmë dëgjesat gjatë ditëve zyrtare. Në programimin e punës nuk ka pozitë dhe opozitë, por ka shfrytëzim të orarit të punës.

Fidel Ylli – Nuk mundet kryetarja të vij e të kërkojë shtyrje në komision, në një kohë që projektkalendari është bërë në mbledhjen e kryetarëve. Ajo flet si “E ëma e Zeqos në majë të thanës”! Nuk mund të sillet kështu, pavarësisht mendimit që ajo ka për projektligjet, t'i votojë apo jo. Nuk mund të ofendojë deputetët.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk mundet ajo!

Kostaq Papa – Ajo është tjetër gjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kostaq Papa - Pozicioni politik është i secilit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Selami Jenishehri - Unë konstatoj që edhe ne, edhe ajo jemi gabim. Kur flet njëri prej nesh, pa mbaruar ai mendimin, ne nuk kemi të drejtë të flasim. Ama, kur të mbarojë ajo, në qoftë se ajo ia pret fjalën njërit prej nesh, ne duhet të bëhemi bashkë dhe t'i themi: zonjë, ju jeni gabim këtu. Ne duhet të jemi të parët që të mos e ndërpresim njëri-tjetrin dhe as atë. Ama, nëse ajo do të na ndërpresë ne, atëherë ne duhet t'i tregojmë se nuk jemi ...

(Debate pa mikrofon.)

Selami Jenishehri – Në kuptimin zyrtar, quhet “zonjë”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mbyllet pika e parë e rendit të ditës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.12.2019, ora 13:00

Drejtton mbledhjen:

Milva Ekonomi – zëvendëskryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

2. Diskutimi nën për nën dhe në tërësi i projektligjit “Për Buxhetin e vitit 2020”
(komision për dhënie mendimi).

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Ramazan Gjuzi, Musa Ulqini, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Bujar Çela, Adelina Rista, Almira Xhembulla, Mirela Kumbaro, Kostaq Papa, Klajdi Qama.

Mungojnë:

Fatjona Dhimitri, Lindita Nikolla, Enada Kapllani, Amra Barova, Selami Jenishehri, Erion Piciri.

Të ftuar:

Shpëtim Shehu - drejtor i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Kulturës,
Vilma Causholli – specialiste në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë,
Suzana Stefa - specialiste në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë
Mirela Bimo - drejtore e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Arsimit,
Sportit dhe Rinisë,
Florian Nurçe - përgjegjës sektori, Sektori i Buxhetit, Drejtoria e Buxhetit dhe
Menaxhimit Financiar, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Vijon pika e dytë e rendit të ditës

Milva Ekonomi – Faleminderit të gjithëve që jeni këtu sot!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Edukimit dhe Mjeteve të Informimit Publik.

Në rendin e ditës në këtë pjesë të dytë të mbledhjes kemi miratimin nen për nen dhe në tërësi të projektbuxhetit të vitit 2020. Prezent janë përfaqësues që vijnë nga tre ministri: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe nga Ministria e Kulturës.

Përpara se të fillojmë mbledhjen për të dëgjuar opinionin e komisionit lidhur me ndryshimet nen për nen dhe nëse do të ketë ndonjë mendim nga të ftuarit, unë do t'i kërkoja zotit Ylli të na japë një informacion për kuorumin.

Fidel Ylli – Kuorumi është i plotë. Unë dua të theksoj se ndjej keqardhje për kryetaren e Komisionit, sepse buxheti është gjëja më e rëndësishme për ne në parlament, por ajo në mënyrë jo korrekte nuk merr pjesë sot në mbledhjen e komisionit dhe e ka bojkotuar këtë seancë.

Milva Ekonomi – Të dashur kolegë deputetë, në mbledhjen e mëparshme ne kemi bërë diskutimin në parim të projektbuxhetit dhe kemi caktuar një relator për të. Unë mendoj që edhe për diskutimin në parim dhe në tërësi të mbajmë zonjën Nikolla si relatore të projektbuxhetit. Ndërkohë, ju kujtoj që në diskutimin e kaluar për projektbuxhetin ne vendosëm dhe morëm përsipër të bëjmë disa kërkesa lidhur me disa ndryshime në zërat e buxhetit, të cilat ia kemi dërguar me shënim Komisionit të Ekonomisë dhe Financave. Me ndihmën e sekretariatit të komisionit unë do të kaloj në diskutimin nen për nen të buxhetit, duke pasur parasysh edhe propozime për ndryshime që mund të kenë përfaqësues nga Ministria e Financave, nga Ministria e Arsimit dhe nga Ministria e Kulturës.

Pjesa e buxhetit që lidhet me nenin nr. 1, të ardhurat dhe shpenzimet e deficitit, do të mbahet kështu siç është?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do të ndryshojë deficitin.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Vilma Çausholli – Ministria e Financave ka përgatitur një skenar të caktuar për ndryshimet, të cilin e ka dërguar në Komisionin e Ekonomisë dhe pasi të miratohet dhe diskutohet atje, atëherë do të flasim me shifra. Por do të reflektojmë ndryshimet, pasi në princip këto nuk ndryshojnë. Vetëm shifrat mund të kenë ndryshime.

Milva Ekonomi – Kolegë, unë ju propozoj që të biem dakord me nenin 1. Ndërkohë, dëgjuam që propozimi për deficitin do të vijë nga Komisioni i Ekonomisë. Kështu që, të biem dakord në parim, sipas propozimit që vjen nga Komisioni i Ekonomisë. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Buxheti.

Edhe këtu duhet të jetë sipas Komisionit të Ekonomisë. Jeni dakord?

Nenin 3. Buxheti vendor për vitin 2020. Edhe këtu besoj se ndryshon sipas propozimit që ka ardhur nga Ministria e Financave në Komisionin e Ekonomisë.

Dakord, sipas propozimeve?

Neni 4. Buxheti i sigurimeve shoqërore.

Edhe këtu do të ketë ndryshime, apo jo?

Do të mbahet siç ka qenë?

Dakord, edhe për sigurimin suplementar.

Neni 5. Sigurimet shëndetësore për vitin 2020. Nuk do të ketë ndryshime.

Miratohet.

Neni 6. Buxheti për fondin e kompensimit në vlerë të pronarëve. Besoj se do të rishikohet. Do të vijë sipas propozimit të Ministrisë së Financave për Komisionin e Ekonomisë.

Kalojmë në kreun II. Burimet mbështetëse për shpenzimet e buxhetit të shtetit, që lidhen me nenin 8. Edhe këtu do të ketë ndryshime sipas Komisionit të Ekonomisë. Kush është dakord t'i miratojmë me ndryshimet?

Neni 9. Të ardhurat e buxhetit. Do të ndryshojë edhe ky dhe do të jetë sipas atyre ...

Neni 10, shpenzimet e buxhetit, do të ndryshojë sipas propozimeve.

Kush është dakord për nenin 10?

Neni 11. Numri i përgjithshëm i punonjësve në administratë nuk do të ndryshojë.

Jeni dakord me nenin 11?

Dakord.

Neni 12 nuk ndryshon.

Neni 13. Fondi rezervë. Nuk ndryshon. Jeni dakord kolegë deputetë?

Miratohet.

Neni 14. Transferta e pakushtëzuar.

Mirela Bimo – Mund të ketë ndryshime.

Milva Ekonomi – Edhe ky nen do të miratohet sipas propozimit që vjen nga Komisioni i Ekonomisë.

Jemi dakord ta miratojmë edhe ne? Dakort.

Neni 15. Për institucionet e arsimit të lartë të shpërndahen në formën e grantit.

Nuk do të ndryshojë.

Neni 16. Kufiri i shpenzimeve, sipas tabelës që mund të shpërndahet nëpërmjet programeve.

Nuk ndryshon.

Miratoohen nenet 15 dhe 16.

Neni 17. Tavani për vlerën e kontratave.

Nuk ndryshon.

Dakord jeni për nenin 17? Dakord.

Neni 18, i cili ka të bëjë me kufirin për rritjen vjetore të totalit të ekzistencës së stokut të borxhit të qeverisjes qendrore. Ne dëgjuam që ky nen do të ndryshojë, kështu që do të merret sipas asaj që propozon Komisioni i Ekonomisë, me llogaritjet që ka bërë Ministria e Financave dhe e Ekonomisë.

Neni 19, që ka të bëjë me emetimin e një eurobondi të ri.

Vilma Çausholli - Nuk besoj se do ta ndryshojmë.

Milva Ekonomi - Edhe këtu do të kemi parasysh që ky nen do të lëvizë. Ne e miratojmë në parim, por vlerën finale të kësaj shume do ta japë Komisioni i Ekonomisë dhe i Financave, sipas propozimit që vjen nga ministria përkatëse.

Për nenin 20, që të caktohet Ministria e Financave dhe e Ekonomisë të nxjerrë udhëzimet, besoj se jemi dakord?

Ju lutemi që në këtë rast edhe ju ta përshpejtonit pak punën, që udhëzimet të dalin sa më shpejtë të jetë e mundur, sepse kemi një vit shumë të veçantë në vitin 2020, për sa u takon punëve dhe ngarkesës sonë.

Unë dua t'ia bëj me dije të gjithë ekzekutivit dhe parlamentit ngarkesën. Gjithashtu, dua t'ju bëj me dije që ne kemi ndarë me Ministrinë e Arsimit edhe tre dokumente për projektbuxhetin: një nga UNICEF-i dhe dy nga sindikatat e arsimit.

Unë nuk e di nëse ju ...

Kam përshtypjen që edhe ju i keni reflektuar ato që në dëgjuesën e parë që kemi bërë: dokumentin e UNICEF-it, sepse ishte dokument i drejtuar te ju dhe pastaj për dijeni te ne, por edhe dokumentet e sindikatave, sepse procedura e vitpasviti është që sindikatat sjellin vërtet një propozim, por ky shqyrtohet nga ministria juaj.

Vjet ne kemi bërë një kopje për sindikatën e invalidëve të punës lidhur me bursën që përfitojnë fëmijët e tyre. Ia kemi kaluar edhe Ministrisë së Financave. Nuk e di nëse do ta keni në vëmendje këtë vit kërkesën që kanë bërë sindikatat e invalidëve të punës.

Mirela Bimo - kanë kërkuar përfitimin e bursave për të gjithë studentët që kanë njërin prej prindërve invalid pune. Nga një statistikë që kanë dërguar në ministri, ishin rreth 540 studentë që duhet të përfitojnë nga kjo masë. Efekti financiar shkonte rreth 90 milionë lekë të reja në vit. Ministria nuk ka bërë një draft konkret për të bërë ndryshimet, por mbase në kuadrin e paketës për universitetin, që do të bëhet për vitin e ri buxhetor, mund të përfshihet, por gjithmonë në varësi edhe ..

Domethënë, duhet të bëhet ndërhyrje në vendimin e Këshillit të Ministrave. Sapo të bëhet ndërhyrja ... Kishte një efekt financiar të konsiderueshëm në vlerësimin tonë ..

Vilma Çausholli - Ju bëjmë me dije se do të shtohet një nen për fondin e përballimit të pasojave të tërmetit, mënyrën si do të menaxhohet e të tjera, por kur të draftohet dhe të miratohet.

Milva Ekonomi - ... edhe për këtë nen natyrisht që ne do të biem dakord në parim, sepse e kuptojmë shumë mirë që ka nevojë për një nen të tillë lidhur me situatën që po kalon sot vendi, por edhe ky nen do të miratohet nga Komisioni i Ekonomisë dhe Financave dhe ne jemi komision që japim mendim për të.

Të dashur kolegë, e miratojmë në tërësi këtë projektligj?

Jeni dakord me projektligjin, me ndryshimet që do të vijnë nga Komisioni i Ekonomisë dhe Financave?

Dakord.

Faleminderit përfaqësuesve që morën pjesë në këtë diskutim!

Është mirë të komunikojmë në vazhdimësi, sepse kjo lehtëson shumë punën mes jush dhe komisionit.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA

